

KRISTAO CEPA (KAPA)

8SH-1

C. 35

PARADA  
DASMĚS e

8JH-1

C 35

KRISTAQ CEPA (KAPA)

5'

# PARADA E DASMËS

Redaktor: MARK GURAKUQI

~~35228~~

11757

TEKA E SHETËTË  
GJIROKAS

## POEZIA SATIRIKE E KAPËS

Kristaq Cepa, i njohun sidomos me pseudonimin «Kapa» asht një ndër autorët e rij përparimtarë të viteve '30, që bani emën. Ai bashkëpunoi kryesisht në revistat «Rilindja» dhe «Bota e Re», ku, pothuajse në çdo numër, do të gjeje vjersha të tij.

Në vjershat e Kapës e në prozat e tij të pakta bie menjherë në sy lidhja e poetit të ri me realitetin, me çështjet e ditës, me problemet aktuale të dorës së parë e, gjithashtu, vërehet përpjekja e tij për t'i pasqyrue në mënyrë realiste, tue përdorë kryesisht humorin e tue arritë, hera-herë, edhe në satirë të mprehtë e sarkazëm therëse. Prapa një buzëqeshje gjysëm të fshehtë gjen një goditje nga ma të randat drejtue kundër regjimit zogollian, klasave sunduese të atëhershme.

Në poezinë humoristiko-satirike të Kapës jepen mjaft anë të realitetit shqiptar në vitet '30. Në te do të gjejmë jo vetëm demaskimin e klasave sunduese të regjimit, të moralit të tyne, por edhe kontrastin e klasave, pasqyrimin e jetës së mjerë të shtresave

të vorfëna, veçanërisht të fshatarësisë punuese, me të cilën autori u muer në mënyrë të veçantë. Tematika e poezisë së Kapës, kandi vizual, nga i cili ai e sheh jetën shqiptare të kohës, lidhen me ate vijë të përgjithëshme të letërsisë sonë përparimtare të viteve '30, me realizmin e demokratizmin e saj, me prirjen e saj të përgjithëshme antifashiste, me ndikimin e saj nga idetë socialiste.

Kapa nuk mbeti një poet me interes krahinor. Ai asht ndër poetët e rij përparimtarë të kohës, që folën mjaft haptas, tue vumë gishtin ndër disa nga plagët ma të randa të kohës.

Kapa asht ndër shkrimtarët e rij përparimtarë të viteve '30, që nxori në shesh fytyrën e vërtetë të «shtyllave» të regjimit Zogist, «baballarëve të kombit», deputetëve sa xhahilë, aqë edhe cinikë e brutalë. Këte e gjejmë ndër disa vjersha. Që në vjershën «Intervistë me drejtorë («Rilindja», Nr. 6,16 shkurt 1935) deputetët zogollianë i thanë drejtorit të revistës, që kërkon t'u mbledhë pajtimet;

*«Lerna mor jahu s'merremi me gramë»*

Kurse në vjershën «Ç'desha t'isha» («Rilindja», Nr. 12 18 Maj 1935) shkruen se nuk don të jetë deputet:

*Se ke shumë andralla, jo fole, jo s'fole,  
Më në fund të thonë popullin e mole.*

Nga këto goditje si në zgrip, në vjershën «Kandidat për deputet» («Rilindja, Nr. 31, 7 mars 1936) ai do të kalojë në një goditje më të hapët e do të na japë me mjeshtëri portretin e deputetit tipik të kohës, tue paraqitë një ndër anët ma tragjikomike të regjimit zagollian. Cila asht «puna» e deputetëve? Ja:

*Në më thënc zotrote se ka shumë punë,  
Kur flasin të tjerët, flej, merrja me gjumë...  
N'u vëntë në votë, fundja më në fund,  
Shokut që ke pranë i thuaj: «më tund,  
Or koleg të lutem, pa kur të flesh ti  
Do t'të zgjoj dhe unë, se sikundr' e di  
Dëgjoke, s'dëgjoke, kjo nuk ka rëndsi:  
Gjashtë muaj gjumë, gjashtë muaj rri;  
Sa për t'ardhurat nga rroga:*

*Do t'i ndaj në popull... me ca pak fajdé.*

Poeti i ri do t'i demaskojë edhe në vjersha të tjera, që përfshihen në këtë vëllim. Ai nuk synonte të godiste vetëm deputetët xhahilë e anadollakë, edhe pse të veshur me rendigotë e smoking. Nxjerrja në shesh e të palameve të tyne, vumja e tyne në lojë, s'ishte një qëllim në vetëvehte, por një mjet për të qëllue vetë regjimin zagollian, që mbështetej në deputetë të tillë, pjellë e vetë feudoborgjezisë e përfaqësuesë të këtyne klasave. Për këtë, Kapa sulmin kundër tyne e lidhi me sulmin kundër «parësisë» apo «fisnikërisë». Këtë e ban që nga disa pjesë të vjershës «Majestik i Korçës» që të vijë në vjershat «Ç'desha t'isha», «Ëndër»;

«Plaku dhe i riu», «Pa gajle, pa halle», «Tituj fisnikërie», «Tituj dhe imzate» etj.

Nji pasqyrë të gjallë të jetës së »parësisë« do të na e japë te një ndër vjershat e tia ma të forta titullue «Pa gajle, pa halle...» E mbasi e përshkruen këtë jetë, përfundon:

*:::Nejse, ç'ka të bënjë, bota kshtu u end,  
Kush i ka paratë thonë ka dhe mend.  
Pra le të dëfrejnë e le t'hedhin valle  
Parësi e vendit pa gajle, pa halle.*

Në »Tituj fisnikërie« do të nënvizojë:

*Çdo njeriu të pasur e që ka të holla  
Në shtëpin' e tij nuk i ngjiten njolla,  
Nuk i ngjiten njolla, jo fisnikërisë  
Se gjakun e kanë të zi, katran pisë.*

Tue u përpkjë të depërtojë në raportin e në marrëdhëniet e klasave në shoqërinë shqiptare të kohës, Kapa ndalet edhe te borgjezia, sidomos te disa shtresa të saj. Me borgjezinë ai do të merret në disa vjersha, herë rrëshqitaz e herë ma gjatë, si në «Ç'desha t'isha», «Reklamë tabele», «Katundari në pazar» etj.

Rehatllëkun, jetën e borgjezisë, të të pasunve, në antitezë rae jetën e shtresave të varfëra, Kristaq Cepa do ta pasqyrojë te vjersha «Tabllora të jetës»:

*Kush ka pare metelikë  
Bën dhe pallto me kozhuk,  
Nga e ftohta nuk ka frikë  
Mban dorashka me pambuk, etj.*

Një pjesë e kësaj borgjezie çfrytëzonte popullin edhe me anë të senetëve e fajdesë. Këtë çështje Kapa e pasqyron ndër vjersna si «Majestik i Korçës», «Ç'na sjell 35-a», «Ç'desha t'isha», «Në Voskopojë», sidomos te vjersha «Kur të hahet haka». Në këtë vjershë autori me mjeshtëri, me anë të një satire, që arrin deri në sarkazëm, portretizon një fajdexhi të egër, brutal e të pashpirt, i cili tallet me fatkeqësinë e të tjerëve, tue i rjepë në mënyrën maçnerëzore: Ai i përkrahun nga ligjet në fuqi, shkon:

*Me senet në dorë në prokurori  
Dhe ia marr të gjitha: shtëpi, ara, dhi  
E ç'kish bagëti, sikur qe seneti...*

Në vjershën e fortë «Intervistë me doktor Kavaljerë» Kandidati për deputet, doktor kavaljeri thekson:

*Do t'i djek senetet, do var fajdexhinjtë*

Çfrytëzim në qytet dhe në fshat. Në shumë vjersha të tija Kapa do të tregojë për gjendjen e mjerueshme të masave fshatare. Aluzionet e para i gjejmë në vjershat «Ç'na sjell 35-a» dhe «Ç'desha t'isha» e në vjersha të tjera, si «Katundari në pazar», «Vrahu duhet he-

dhur», «Ta gënjejmë vehten» «Tabllora të jetës» etj. Në «Katundari në qytet» poeti shkruen:

*Pa njerës të veshur: me roba, këpucë...  
Sheh këmbët e tia ... i kishte në lucë.*

**E përsëri:**

*Por pa dhe pallate: me gurë, me bojë  
E hoqi dhe pipën, që mbante në gojë  
E kujtoi kalibën: pa oxhak, pa derë...  
Që shiu dhe bora nuk e lën' të flerë; —  
Pa dhe djem të vegjël, një sa djal' i tia  
Që vdiq aty moti nga smundje... uria!*

Edhe më tej në paraqitjen e mjerimit të fshatarësisë së vorfën Kapa shkon në vjershën «Vrahu duhet hedhur», ku gjejmë tablo të tilla:

*Puno pa pushuar, lere e remi  
Me gra, me fëmijë, coptou, dërsi  
Dhe fundi së fundi, ç'ke nxjerë në shesh?  
Ha bukën pa kripë, për gjellë s'ke presh:  
Banesë kasollen, pa rroba në trup,  
Dhe je i fuqishëm, mban botën mbi sup....*

Për mungesë të kushteve materiale ma elementare flasin këto vargje të vjershës «Ta gënjejmë vehten»:

*Sheqerin, kafenë, si lesht e devesë  
Në katund s'i gjen dhe në vrafshi pesë.*



Kapa nuk u kufizua vetëm të pasqyrojë gjendjen e randë e të mjerueshme të fshatarësisë sonë punonjëse, por shkoi edhe ma tutje. Poeti arrin të hetojë edhe zemrimin, revoltën, qoftë edhe ende jo aqë të ndërgjegjëshme sa duhet, që vlonte në gjinin e fshatarësisë së çfrytëzuar. Natyrisht, kuptohet, kjo revoltë asht shprehun në shumicën e rasteve në mënyrë të tërthortë, nëpërmjet aluzionesh e nëntekstesh. Por, ndonjiherë edhe ma hapët, ma drejtpërsëdrejti, si ndodh p.sh. nga fundi i vjershës: «Katundari në qytet»:

*... Po kur pa paratë me mostr' e sarafit,  
U mahnit dhe tha: Do vete t'i marr:  
Ktheu kryet prapa dhe pa një xhandar,  
Shpejt e mblodhi vehten dhe shkoi te  
nallbanë  
E mori gomarë.... u nis për nga fshati*

Me realizëm Kapa përshkruen këtu se katundari nuk asht çliruem ende nga frika e «xhandarit», që përfaqëson brutalitetin e regjimit të Zogut. Ai ende nuk ka brumosë aqë sa duhet ndërgjegjën e vetëdijën e tij të klasës. Ky pasazh të kujton atë puntorin e pa punë të prozës «Moll' e ndalueme» të Migjenit.

Këtë ndjenjë revolte Kapa do ta çfaqë edhe më haptazi në këta vargje të vjershës «Plaku dhe i riu».

*Kështu është e shkruar, kështu është e thënë».  
Thonë njerëzia, ata mëndjelënë.*

*Jo, nuk është fati...po je ti e unë,  
Që jemi verbuar e jemi në gjumë...  
... Më s'na mban me shpresë jet' e amëshuar,  
Fund' i rruzullimit duhet kërkuar,  
Në botën e vdekur plot helme, siç rrojmë,  
Të çpallim të drejtën dhe jetën ta çmojmë,  
Se s'humbi gëzimi dhe shpresa e saj,  
Jo t'ia krisim kujes me lot' e me vaj...*

Kurse në vjershën «Pa gajle pa halle», mbasi na ka paraqitë jetën e çkujdesun e gjithë qejfe të parësisë, në kontrast me mjerimin e fshatarësisë, autori shton:

*Po kur mbushet kupa me vojtjet e tia  
As nga ti s'do ndihmë, as nga Perëndia...*

Kapa u përpoq të japë jo vetëm revoltën e fshatarësisë, por të hedhë edhe një sy në të ardhmen. Natyrisht ai nuk shkoi shumë larg, s'harriti në kërkesa të kristalizueme mirë për një rend të ri shoqëror socialist. Megjithëkëtë, paraqesin shumë interes disa nga pjesët e «Programit» të Doktor Kavalierit, i cili, sikur të bahej deputet, do të kryente reforma të tilla:

*Seftë bujqësinë, pastaj tregëtinë,  
Do t'i thanj dhe gjolet, do shtonj bagëtinë,  
Borxhet do të falen, si thotë «Soloni»  
Vetëm tetë orë ditën do punoni;  
Puna do të shtohet, rroqa do madhohet etj.*

Ai do të bante edhe një të mirë tjetër:

*Do t'i djek senetet, do var fajdexhinjtë.*

Kritikës kundër rendit në fuqi i shtohet kështu edhe mendimi i autorit për një shoqëri të ardhëshme më të mirë.

Kapa merret edhe me disa probleme të tjera shoqnore, që, megjithëse s'kanë rendësinë e atyre, që kemi shqyrtue ma nalt, prap vlejné për të theksue disa anë të tjera të jetës shqiptare të kohës.

Një ndër këto probleme asht pasqyrimi i jetës parazitare të zvetnueme të parësisë e të rinisë së pasun, që e kalonin jetën me pije e me kumar («Majestik' i Korçës», «Në Voskopojë» etj.).

Tue vijuem pasqyrimin e disa anëve negative të shoqnisë feudoborgjeze, Kapa merret edhe me çështjen e «Prikës», që ishte një plagë e randë, sidomos në disa krahina të vendit e në mënyrë të theksueme në Korçë («Majestik i Korçës», «Intervistë me drejtorë», «Drejtori kandidat për martesë», «Ç'desha t'isha», «Paja», «Peshqeshet e vitit të ri», «Modha» etj.)

Kapa merret edhe me disa aspekte të tjera të jetës së atëhershme shqiptare, si p.sh. tepri-  
met e modës etj.

Në poezinë e Kapës gjejmë edhe disa nota afetare, rrëshqitaz, jo n'ato përpjestime, që hasim te Migjeni e Nonda Bulka («Pa gajle, pa halle», «Plaku dhe i riu» etj.) E vetmja vjershë fund e krye antifetare ku autori lufton shpërdorimit e klerikëve, asht ajo që titullohet: «Po kërkonj ilac»:

*Plaka nomatisti, dervishi më shkroi,  
Hoxha më dha nuskë, prifti më këndoi,  
Cili do pas qejfit më ropi më çveshi  
Mir' ma bënë, e desha, kshtu pëson syleshi.*

Kapa nuk u muer me probleme të letërsisë e të artit, e me çështje letrare, si Petro Markoja, Nonda Bulka, Dhimitër Shuteriqi, Misto Treska etj. Por në disa vjersha të tia gjejmë pasazhe, që sqarojnë qëndrimin e poetit kundrejt letërsisë e artit në përgjithësi në këtë kohë. Jo një herë Kapa ngrihet kundër «artit të lirë» të degeneruëm, që kërkon të ngjallë sensualizëm tek lexuesit a spektatorët («Ç'na sjell 35-a» «Revistës Diana» etj.)

Nji aluzion për shtypin zyrtar të subvencionuëm, që fallsifikonte e zbukuronte realitetin në dobi të regjimit, gjejmë në vjershën «Dimri», ose në vjershën «Fjalë boshe»

Kapa do të ngrihet edhe kundër një tendence nihiliste e pesimiste, që kishte kapur ndonji shkrimtar të ri. Dhe kjo dëshmon për optimizmin e poetit, për besimin në njeriun, në jetën që e vlen ta jetosh. Në shkrime si «Peshqeshet e vitit të ri» dhe «Përgjigjia e përgjigjes së përgjigjes: filosofi në stratosferë», ai do të lëftojë kundër spekulimeve filosofike idealiste të ndonjë «mendimtari» të kohës.

Te Kapa nuk do të gjejmë ato aluzione të shpeshta të një Migjeni kundër kapitalizmit të huej, imperializmit, apo fashizmit, ose atë të folun troç, që gjejmë në mjaft shkrime të asaj kohe të Nonda Bulkës; megjithëkëtë, prap, alu-

zionet nuk mungojnë dhe këto dëshmojnë se problemet me rëndësi të gjendjes ndërkombëtare, si dhe pikësynimet dhe qëllimet e nazifashistëve, nuk ishin të panjohuna për 'të. Këtë e vëmë re në disa vargje të vjershave «Majestik i Korçës», «Ç'na sjell 35-a», «Elbasani», «Gazetarët», «Tituj dhe imzatë» etj.

Kapa asht një poet thellësisht politik. Ai e lidhi poezinë e tij me jetën, me problemet shoqërore, me çështjet e ditës. I nisun nga prizmi i interesave të masave të vorfëna punuese, ai ia doli në krye të japë disa nga aspektet me të randësishme të realitetit shqiptar të kohës së tij.

Marrja me disa nga problemet ma të rëndësishme të kohës i dha poezisë së Kapës atë bazë realiste, që qe një ndër faktorët e dorës së parë në popullaritetin e fituem nga autori në ato vite. Tue pasë të përbashkët, me shkrimtarët e tjerë të rij përparimtarë të viteve 30, tendençën realiste e problematikën shoqënore, Kapa na paraqitet me veçori të stilit të tij, të individualitetit të tij poetik. Ai asht kryesisht një poet humoristik e satirik. Ai shkruen, pa e ngarkuem poezinë e tij me figura. Vjershat e tij shpesh marrin karakterin e një bisede me lexuesin.

Në përgjithësi, ato kanë ton tregimtar. Ngjarjet zhvillohen pa ritme dramatike, ngadalë, shtruem. Veç elementeve satirike, gjejmë mjaft shpesh edhe nota të holla lirike, sidomos kur Kapa na flet për njerëz të thjeshtë të popullit. Kapa në përgjithësi nuk krijoi personazhe të individualizueme thellë; në vjershat e tia

ai ma tepër dha kuadro e aspekte të realitetit të përditshëm shqiptar, ku gjejmë të skicuem ose të porsaskicuem një mori tipesh e personazhesh; ate e interesojnë ma tepër ambjenti, atmosfera e përgjithshme, në dhanien e të cilave u tregue mjaft i shkathët. Qoftë edhe pse nuk ngul kambë në krijim tipesh e personazhesh të plotë, Kapa i ka përshkue me disa veçori e karakterisika aq tipike, saqë para nesh del mjaft e skalitun koha me njerzit e saj.

Kapa asht mbështetun në folklor. Vetë gjashtërokëshi i dyzuem dhe tetërrokëshi janë një dëshmi e kësaj mbështetjeje. Nga folklori Kapa ka marrë qartësinë e shprehjes, ndërtimin e drejtë të vargut, thjeshtësinë, ato shprehje të figurëshme e lokucione, që ndryjnë vetë urtinë popullore. Qe bash kjo mbështetje në floklor e në gjuhën e popullit një ndër arsyet kryesore që e banë Kapën, aq të njohun e të afërt për masën e lexuesve.

Kapa ka krijuë mirë atmosferën shqiptare, veçanërisht ambientin Korçar. Ambjenti e atmosfera jepen në detale, me nuanca vërtetë tipike: («Dimri», «Për vizita me zonjën», «Parada e dasmës», «Muhabet Sofati» etj.)

Ja disa vargje nga vjersha «Muhabet Sofati»:

*Po shetisja rrugës si i dembelosur.  
Në çdo prak e portë gratë qen' radhosur.  
Plaka rri tjerr leshnë me furk' e me bosht.  
Nga kujtim' i jetës nuseve iu thosh,  
Si shkoi çupërinë e si qe martuar.  
Sa vjet shkoi me burrin, praknë s'kish kaluar.*

*Vajzat i ven vëshin, qeshin, qesëndisin  
Me kohën e shkuar. Shpejt e shpejt qindisin.  
Me kto llërë jashtë, me kta thonj me majë,  
Qëndisin e qepin, përgatitin pajë... etj.*

Kapa në përgjithësi përdor vargjet monokolone. Tepër rrallë përdor strofën. Në punë të metrit gjejmë zakonisht vargun' gjashtërokësh të dyzuem, tetërokëshin, si dhe kombinimin e tetërokëshit me katërrrokëshin. Rrima në përgjithësi asht e puthun.

Në poezinë e Kapës vërehen edhe të meta.

Autori nganjherë merret me çashtje të imta, me vogëlsira pa ndonji randësi politike e shoqërore. Pjesë të tilla do të gjejmë në vjershat («Qyteti i kontrastit», «Intervistë me drejtorë», »Drejtori kandidat për martesë»,) Gjejmë edhe vjersha të dobta, si «Botime të reja», «Galeria e revistës», «Duke rrjedhur koha» etj.

Në vjershat, që përmendëm e në ndonjë tjetër, ma tepër se poezi të vërtetë kemi versifikacion. Autori e tepron me lehtësinë, që ka në punë të vargëzimit e bie kështu në vargje të rëndomta.

Ky prozaizëm që vihet re në mjaft vjersha të Kapës, lidhet, në shumicën e rasteve, me një proliksitet të dukshëm, që dëmton cilësinë artistike të vjershave. Një farë ndikimi për të keq, në këtë çështje, ka ushtruar edhe kujdesi i pakët i autorit, lidhur me intonacionet ritmike. Përdorimi, pothuajse gjithmonë, i gjashtërokëshit të dyzuem monokolon, me rrimën e zakonëshme *a a*, asht një ndër shkaqet kryesore

të asaj monotonije, që ndihet në vjershat e Kapës. Jo aqë kujdes ka tregue autori edhe në punë të fjalorit poetik. Ai në përgjithësi asht kufizue në disa kategori fjalësh e shprehjesh, që, kur teprohen, fillojnë e bahen të rëndomta, monotone.

Kapa mbetet një ndër autorët më interesantë të letërsisë sonë përparimtare të viteve '30. Poezia e tij paraqet interes të dorës së parë për tematikën dhe përmbajtjen e saj të thellë demokratike. Me vjershat e tia ma të mira Kapa zë një vend të randësishëm në poezinë tonë satirike të periudhës 1912-1939.

MARK GURAKUQI



# VJERSHA

**PRILLOTEKA E SHTETIT  
GJIROKASTER**

~~35228~~

11757

## MAJESTIK' I KORÇES 1)

Majestik' i Korçës, një kafe në pjaçë,  
Venë shkojnë kohën, kur s'dalin sullaçë,  
Një pjesë e rinisë, një pjesë zyrtarë  
Do t'ju them ç'dëgjova, do t'ju them ç'kam  
parë:

Që kur hyn te dera dhe gjer te bufeja  
Plot klient' është mbushur, s'ka ku hidhet veja;  
Ca lozin, ca flasin, ca qërojnë hesapin,  
Të gjithë sa venë «purbua» 2) nuk japin.

Në tryezën ngjitur rrin' ca pësanikë,  
Që kur ngjau një vrasje u ka hyr' një frikë,  
Sa s'din' ku të fshihen, ku t'i ven' paratë,  
Çdo çoban, kur shohin, trëmben, u ven' shtatë,

1) U botue në revistën «Rilindja», Korçë, Viti I, Nr. 1 datë 28 Nëntor 1934, me pseudonim Kapa. E japim me shkurtime.

«Majestiku» në vitet '30 ishte kafeneja më e ndëgjuese e Korçës. Aty mbledhej «ajka» e feudo-borgjezisë. Nëpërmjet «Majestikut» autori na jep disa anë të jetës morale të këtyre klasave, veset, boshllëkun e tyre shpirtnor. Nga kjo pikëpamje, vjersha paraqet mjaft interes.

2) bakshish kamarierit.

.....

Një tufë djelmosha xholit ia kan' shtruar,  
Dhe disa prej tyre janë të martuar:  
Vazhdon lodra natën, njerin bëjnë arkë,  
Harrojnë se gratë i presin për darkë.

.....

Katër në tryezë janë veshur shik,  
Po lozin një poker aristokratik;  
«Dy per» i thot' njeri, tjetri thotë «flesh», 1)  
Të tjerët nuk flasin, kanë letrat bosh.

Ja, ca djem të rinj pa qime në faqe,  
Pan' se vura veshin, qëndruan sa kaqe:  
Njeri ka një letër, që ia paska shkruar  
Një vajz' e qytetit, q'e pat dashuruar.

Ca pa lesh në kokë flasin politikë;  
Ç'bëhet në Evropë, ç'bëhet n'Amerikë,  
Si qëndron sot Franca kundrejt Gjermanisë  
Dhe në plastë lufta për shkak t'Japonisë. 2).

Tre në një tryezë duhan' ndes e shuaj,  
Nuk janë Korçarë, po janë të huaj;

---

1) «Dy per» e «flesh», kombinime letrash në poker.

2) Shkarazi, me mjaft marifet, në këtë strofë autori ban aluzion për gjendjen e ndeme të krijueme në botë, tue vu në shejë; tërthorazi, dy nga fuqitë ma agresive t'asaj kohe, Gjermaninë hitleriane e Japoninë militariste, që, bashkë me Italinë fashiste, shpërthyen luftën e dytë botnore.

Habiten për lluksin, se e shkon Parizë...  
Dhe ankohen bota, thonë: «kemi krizë!» 1)

Një me bark të gjerë po flet për qamet,  
U tregon gjith miqve se kish një senet,  
Kish lëshuar t'holla me fajdé pa masë,  
Dhe do merrte shpira me an' të davasë.

Ca flasin për gjuhë dhe ca për muzikë,  
Dhe disa të tjerë kanë hall për prikë,  
Ca avukatllëke 2), ca për mjekësinë  
Dhe një s'bënte fjalë, veç për historinë.

...Majestik' i Korçës, kafe mbi kafetë,  
Sa rri në tryezë, garsoni vjen' vetë,  
Mbushur plot me një rëz dhe gjer te bufeja,  
Ju lutem më falni, se m'u ftoh kafeja.

---

1) Në vargjet e kësaj strofe autori prek dy çështje: kritikon nga njana anë, ata që e teprojnë me modën e me lluksin (e këtë do ta bajë edhe në disa vjersha të tjera edhe ma gjatë) e nga ana tjetër, flet për krizën, që kishte kapë edhe Shqipninë.

2) Nënkupto: ca flasin për avukatllëke.

## QYTET' I KONTRASTIT 1)

Kjo Tiran' e kuqe në një rrëzë mali,  
Vete kërkon punë si çupa, si diali;  
Kjo Tiran' e kuqe rrugët me pllakaq<sup>2)</sup>  
I përngjjet mësallës, q'është me dy faqe:  
Ç'të kërkosh gjen brënda, të gjitha jan' boll,  
Her' je në Paris, her' je n'Anadoll <sup>3)</sup>  
Diku po na vajtka me maqin' një zonjë, <sup>4)</sup>  
Po na vjen dhe gega myshterinj' të ftonjë,  
Se s'i shkon salepi, nuk i shitet boza...  
Pjacës ca zonjushe kan' dal' t'marrin poza.  
Aty të sheh syri gratë elegante,  
Veshur sipas modhës me duart me gante,

---

1) U botue në revistën «Rilindja», Korçë, Viti I, Nr. 2, Datë 15 Dhjetor 1934, me pseudonimin Kapa. E japim me pak shkurtime.

2) pllaka.

3) E ka fjalën për veshjen, për paraqitjen e njerëzvet. Nga njana anë njerës të veshun, sipas modës së fundit (si në Paris), nga ana tjetër njerës të veshur, si në kohë të Turqisë.

4) Nënkuptohet: një zonjë pësanike, në kontrast me gegën (shitësin prej gegnive) që s'arrin dot të shesë as salepin, as bözën, se njerëzit s'kanë para.

Képuçë nazike, çantën nën sjetull,  
 Tunden, kapardisen, t'marrin gjak në vetull. 1)  
 Por sheh dhe të tjera veshur me çarçaf;  
 Mbuluar dhe kokën, q'e habit tuafë;  
 Në vend të këpuçës nallanat heq zvarrë,  
 Me një sy sheh rrugën, kur gjezdis pazarë.  
 Shih kostum i burrit me stof' inglizi  
 Dhe bastun në dorë, ka marraz Parizi;  
 Kostume të ndryshme, modhe tyrlish modhë,  
 Ca të hekurosur dhe ca siç u ndodhë:  
 Zhaqetë stolisur plot me thekë-thekë  
 Dhe për pandallona veshur benevrekë;  
 Ca qylaf në kokë, disa me bombera,  
 Ca dalin pa shapkë dhe ca me berera,  
 Ca, në vend të shapkës, lidhin një shami,  
 Plot qostekë gjoksin, kobure dy-tri. 2)  
 Çdo kostum të duash e gjen' në Tiranë  
 Dhe në daç t'i shkruash nuk ia del dot mbanë.  
 Gjithë tyrlë gjuhësh dëgjon për minutë, 3)  
 Gjen nga gjithë kombet, për veç se çifutë.  
 Një lëvizje e madhe, kryeqytet i thonë,  
 Sa dot s'e merr vesh as qeni të zonë,  
 Ca venë e ca vinë, një kallaballek.

---

1) Tallje me ato femna, që e teprojnë me modën e më lluksin.

2) Jepet në dy vargje, mjaft bukur, portreti i jash-tëm i Kapadajve të kohës (bajraktarë, feudalë, njerës të regjimit), që kapardiseshin e paradonin nepër kryeqytet, tue vumë në dukje armatosjen e tyne plot stoli e ojna.

3) S'e ka fjalën vetëm për të huejët, që mund të ndodheshin n'atë kohë në Tiranë, por edhe për ata shqiptarë, që, për snobizëm, flisnin në gjuhë të huej njani me tjetrin.

Hotel' e kafera aty jan' bollek.

Kush shkon në kafé, që të pij' një kupë,  
Rri atje, ku ndodhet, si garsoni një çupë;  
«Helbete, të thotë, ka lezetn' e saj,  
Kur servir zonjusha kafe ose çaj.. 1)

.....

Ktu këtjé në fushë ngrehur ca pallate,  
Binara të reja me tri-katër kate;  
Dalngadalë ngrihet një Tiranë e re,  
Se qytet i sotmë popullin s'e nxe;  
Hallbu nuk kalohet, se ka balt' e lucë,  
Kush kalon s'andejmi mbetet pa këpucë...  
Në Tiranën tonë, në kryeqytet,  
Veç me sinemara zbavitet mileti; 2)  
Në vend të baletës, aty jan' çengitë, 3)  
Që t'heqin mërzinë, nata bëhet ditë,  
Dhe kshtu kalon koha, gjer n'orët e para.  
Pastaj, për të fjetur është hotel «Ferrara». 4)

.....

---

1) Aluzion për kafe «Kursalin», një nder qendrat ma të mëdha të korrupsionit e të zvetërimit n'ato vite.

2) I vetmi defrim për popullin asht kinemaja.

3) Ky varg, si edhe ai i sipërmi, ven gishtin në një plagë të randë të asaj kohe: amullinë kulturele e artistike.

4) Ma tepër se hotel, një shtëpi publike e njohun. Të vëhet re, si autori, mbasi flet për qejfin që «elita» ban me çengitë, na çon (ose, ma mirë, i çon) në «Ferrara». Në këta pak vargje ai nxjerr në shesh boshllekun e zvetnimit e njerëzve të regjimit.

## Ç'NA SJELL 35-a 1)

Mbaroi vit' i vjetër, erdhi vit' i ri.  
Aj të shohim fatin, si unë, si ti,  
Nuk do t'ndaj peshqeshe sikur është zakoni,  
Mos ju mbetet hatri, mos u zëmëroni.  
Do t'hedh fall me letra ç'do na sjellë moti,  
Do flas si profitët, jo fjalë së koti,  
Do ju them kësmetnë për tridhjetepesën  
Pa hilë në letrat ju them besa besën.  
Ja, i preva letrat, një fletë do heq:  
Tregon se u bëtë dhe një mot më pleq.  
Kjo tridhjetepesa është numur tek:  
Në një vend të botës do bëhet dyfek. 2)

---

1) U botue në revistën «Rilindja», Korçë, Viti I, Nr. 3, datë 1 Janar 1935, me pseudonimin Kapa. E japim me shkurtime.

2) Gjendja ndërkombëtare ishte ashpërsue për faj të fuqive fashiste, si Italia, Gjermanija, Japonija, por edhe të «demokracive» borgjeze, si Anglija e Franca, që me politikën e tyre antikomuniste, u hapnin rrugë e u banin lëshime fuqive fashiste. Në këtë vit, më 1935, Italia fashiste do të sulmonte Abisininë.



Do kërlshen popuj, do pëlcasë topi,  
 Gjithë municionet do t'i japë Evropi,  
 Nëpër gjith' Evropën' do ket' konferenca  
 Të mos mbajnë armë, të përhapet shkenca,  
 Të mos bëhet lufta me mjete barbare,  
 Ja luftë kimike, ja mos bëhet fare. 1)  
 Franca do jet' Francë, Gjermani Gjerman..  
 Zor të bëjnë luftë asnjërit s'ia mban.  
 Një ballon' do ngjitet përmi stratosferë,  
 Një njeri nga hëna mbi tokë do bierë  
 Për të rregulluar krizën dhe buxhetet,  
 Se përndryshe s'dilet, zor e kanë shtetet. 2)  
 Thuhet se kte vit na vjen superkriza  
 Dhe kshtu gjith' beharë nuk do kemi miza; 3)  
 Ata që do smuren' do marrin doktorë  
 Dhe kta nga dollari nuk do heqin dorë;  
 Kush me veresie ilaçe do marrë  
 I sigurt të jetë, vetë e bëri varrë.... 4)

---

1) Të vihet rë në këta katër vargjet e fundit, toni therës, i mprehtë sarkastik i Kapës drejtue kundër fuqive imperialiste, të cilat, nga njana anë, nëpër konferenca ndërkombëtare flasin për çarmatim e për përdorim paqësor të realizimeve të shkencës, e, nga ana tjetër, përgatiten për shpërthimin e një lufte çfarosëse.

A nuk tingëllojnë aktuale këto vargje?

2) Nji aluzion tjetër për krizën, por edhe një tallje e hollë lidhë me pretendimet e teoritë e imperialistëve se nga kriza mund të shpëtohet vetëm me anë të një lufte.

3) Nënkupto: s'do të kemi miza, sepse do t'i vrasin njerëzit e mbetun papunë, për shkak të superkrizës. Kujto shprehjen popullore: «Po vras miza».

4) Kush, për të blemë ilaçe, do të jetë i detyruem të marrë borxhë të jetë i sigurtë se ia bani vehtes varrin, sepse s'do të jetë në gjendje të paguejë borxhin e atëherë...

Më tregojnë lëtrat se pun' e fajdesë  
(Me gjith' se këtyre nuk u jepet besë)  
Do të jetë e pakë, jo si gjer tani,  
Borxhet do të falen që nga Vit' i Ri. 1)

.....

Po dhe sa për modhën, zonjusha, dëgjoni:  
Ta nisim me radhë, nga kombinezoni:  
Ky s'do ket' ndryshime, vetëm se fustani,  
Do ndryshojë shumë, jo si ky që mbani;  
Do bëhet m'i gjatë, dekolletë i hapur,  
Me një rryp të hollë në sup do jet' kapur;  
Kapella do jetë... s'di dhe un' se si,  
Herë si tenxhere, herë si tepsî;  
Për tridhjetepesën çorape s'do ketë  
Dhe thonjtë do mbahen shumë më të gjatë;  
Të kuqt' e të bardhët do jet' me dyzina,  
Nuk do duki njerëz, porse figurina... 2)

.....

Me që do të jenë t'rralla napolonat  
Do bëhen të ngushta shumë pantallonat.

---

1) Nënvizim i faktit se njerëzit janë mbytur në borxhe e se fajdexhinjtë u pijnë gjakun; por edhe tallje lidhë me iluzionet se fajdeja do të zbresë e borxhet do të falen. U ba shumë zhurmë n'ato kohë, edhe në parlament, lidhë me **moratomimin**. Por këto mbeten vetëm fjalë.

2) Në të gjitha këto vargje Kapa tallet, me të drejtë, me teprimet e modës. Vargu i fundit e jep edhe mja thellë idenë e autorit: gratë s'do të duken gra, por figurina (e manikina).

Dita shum' e vogël, nata si tërkuzë,  
Te njeri, te tjetri, muhabetet shpuzë,  
Muhabetet shpuzë, kohën kshtu e shkojnë,  
«Suare» pas darke ngahera ia shtrojnë;  
Aty nxjerrin' mollë, gështenja dhe arra,  
Vera shkon si lumë në kupat e lara  
Bromp njeri, bromp tjetri, zbras kupat dhe qasu,  
Vjehrrës me një kupë dhëndri ia bën jasu.

Dhe ata të gramës 1) flasin ç'thot' gazeta,  
Cilat jan' gënjeshttra, cilat të vërteta; 2)  
Hapen bisedime për miq e për shokë,  
Kush po pasurohet dhe kush bëhet trokë,...

.....

Her' e her' zbaviten, lozin me filxhan,  
Kujt t'i bjerë unaza i ven' një nishan;  
Tregohen përralla, mesele 3) të vjetra,  
Për të shkuar kohën ca lozin me letra;  
Po dhe nganjëherë, kur kan' zë të mirë,  
Këndojnë dhe këngë nëpër mysafirë.

.....

Muhabet i shtruar, këng' e valle plot,  
Pleqtë devolliçen, të rejat fox-trot.  
Në behar të tjera, në dimër mantotë,  
Kto janë të trasha, kto na mbajnë ngrohtë.

- 
- 1) Ata me shkollë, me dije, me kulturë. Greqizëm.
  - 2) Aluzion për gënjeshttra e shtypit zyrtar.
  - 3) Ngjarje, ndodhi, histori. Turqizëm.

Shoshonë për gratë, galloshe për burra,  
Këmba na rri ngrohtë, m'e nxehtë se furra,  
Dhe duart me gante 1) brenda në lëkurë..  
Bjer e fryj dëborë, frik' s'të kemi kurrë,  
S'kemi frikë kurrë, më s'na çan as topi,  
Gjithë ç'kemi veshur e ka bër' Evropi, 2)  
E ka bër' Evropi, mall të siguruar,  
Që ne të na mbrojë nga dimr' i tërbuar!..  
Ç'u bë vëndi i ynë, porsi Elveti, 3)  
Një shumic' e djemve baresin me skf,  
Shkasin mbi dëborë, breg më breg i gjen,  
Do blejnë dhe vajzat... por dimrin që vjen!..  
...Sa mir' që do t'ishte dimër t'ish ngahera,  
Të shijon dhe vera pas darke te vjehrra.  
Pas darke te vjehrra ha, pi qelepër,  
Të lëshojnë këndin, se je mysafir..

.....

---

1) Dorashka. Nga frengjishtja,

2) Satirë e hollë për regjimin, që çdo gjë e sjell  
nga jashtë e s'ndërton këtu fabrika.

3) Zvicra, e njohun për vendet malore të mbulueme  
me borë.

## Ç'DESHA T'ISHA 1)

Sikur t'na e linte Zoti ne në dorë,  
Siç ua pat lënë disave shenjtorë,  
Dhe të zgjidhnim vetë t'bënim si të donim,  
Besonj se në botë t'lumtur do të rronim...

... Dhe sikur pas meje t'vinte gjith mileti  
Dhe të merrnja vota sa ç'merr deputeti,  
Ktë gjë s'do ta donja, s'do kishnja dëshirë,  
Pa s'ka gjë se rroga është goxha e mirë 2)  
Se ke shum andralla: jo fole, jo s'fole:  
Më në fund të thonë: «popullin e mole!» 3)  
Çifligje nuk donja, as titull pasha,  
Efendi, aga, nuk i kam sevda,  
Shkrimtar s'do m'pëlqente, as dhe historian,

---

1) U botue në revistën «Rilindja», Korçë, Viti I, Nr 12, Datë 18 Maj 1935, me pseudonimin Kapa. E japim me shkurtime.

2) Asht goditja e parë, e tërthortë, kundër deputetëve zogistë, që merrnin rroga «goxha» të mira.

3) Goditja vijon. Në mënyrë indirekte demaskon deputetët zogistë, që, me të vërtetë, e milnin popullin.

Të punoj me mëndje, ose me çekan;  
 As sheqer mos shisnja, as malifaturë; 1)  
 Këpucë mos bënja, mos mbanja as furrë;  
 Tregëti mos bënja, mos isha sarraf;  
 As me qehallarë dhe bej me taraf;  
 Hoxhë s'më pëlqente, por as prift me rrasë,  
 Që t'i bënja lutjet me barr' e me thasë.  
 Bujk mos dhëntë Zoti, se nuk ka më keq,  
 E shihni dhe vetë i mjeri seç heq; 2)  
 Fajdexhi mos isha të fundin e herës,  
 Moratoriumi është në prag të derës;  
 Gjeneral nuk desha, oficer me pallë,  
 Merr nishan në gjoks e një plumb në ballë...  
 Desha t'isha grua... grua dhe jo tjetër,  
 Por grua e ré, jo grua e vjetër...

.....

Me gjith' kto sa thashë, përsëri kam frikë:  
 Ku do gjenja burrë, po mos kishja prikë? 3)  
 Haj, lanet i qoftë, bota s'ka karar,  
 Për gjërat e tjetrit bëhet tahmaqar;  
 Të mira, të liga, të gjitha sa kam,  
 Do t'i mbanj për vehte, do rri kshtu si jam...

1) manufakturë.

2) Në këto dy vargje Kapa hedh një mendim shkarazi, lidhë me gjendjen e bujkut, me vuetjetet e mjerrmin e tij. Këtë do ta shjellojë gjanë e gjatë në disa vjersha të mavonëshme.

3) Ajo e prikës ishte një çështje shoqërore me rëndësi. Sidomos në disa krahina të vendit, si në Korçë, për shëmbull, puna e prikës kishte rëndësi. Pa të, vështirë se një vajzë mund të martohej. Me këtë plagë të shoqërisë së atëherëshme Kapa do të merret ma gjatë në vjersha të tjera.

## PARADA E DASMËS 1)

Seç po vjen një grumbull, gra e burra tok,  
S'ka ku hidhet molla, ku qëndron një zok,  
Gjith' ecin me hapa e dal' e ngadale,  
Vijnë bulevardit, rrugës principale. 2)  
Vijnë si llazoret, vijnë palë-palë,  
Martojnë një çupë, martojnë një djalë,  
Kanë dalë rrugës, pjacës paradojnë,  
Duan që të duken, bota t'i shikojnë. 3)  
Dhe qoshe më qoshe rendin njerëzia,  
Se kalon një dasmë, kjo është çudia;  
Rendin t'shohën nusen si po nusëron,  
Buqetën me lule, këpucët me fron,  
Kurorën me tela, prapa me duvak,  
Dhëndërrin, q'e merr është djalë a plak...

1) U botue me pseudonimin Kapa, në revistën «Rindja», Korçë, Viti I, Nr. 13, Datë 1 Qershor, 1935. E japim të plotë.

2) Rrugës kryesore.

3) Ironi: poeti ve në lojë maninë për t'u dukë, për t'u tregue të tjerëve: qe, ç'ka jam.

Tu-ru-ru gërneta, viu-viu violia,  
Nusja shkon me tempo, rrotull njerëzia,  
Përçark me zonjusheri njëra mban duvaknë,  
Dhe vllami për krahu i tregon sokaknë.

Ja, disa nga krushkat kthehen e vështrojnë  
Dhe me zë të unjtër ven' e këshillojnë:  
«Ngre trupin moj nuse, bëju më të qeshur,  
Mos e thyej mezë; korsë pse s'ke veshur?»  
Dhe bylyku 1) prapa me dhëndrrin në mes,  
Dhe ky i krekosur porsi një këndes,  
Kumbaren ka pranë, po dhe plot të tjerë;  
Hidhet një nga djemtë: — Aj, t'ia marr njëherë 2)  
Këngë djalërie, këngë dashurie;  
Gjith' rrugës gërneta një avazi — i bie.  
Në mes të bylykut, ja dhe një uratë, 3)  
Që t'u ver' kurorë më nja ora shtatë.  
Nusja me të bardha, dhëndrri me të zeza,  
Njeri si gallofi 4), tjetra porsi veza 5);  
Nusja ndrit, si drita, si në fund dhe krye,  
U! lum kush e mori, se nuk u gënjye,  
Dhe dhëndrri i zi si nata pa hënë,  
Si dhëndrrit dhe nuses nur u paska rënë,

---

1) Turma.

2) Haide t'ia marrim këngës një herë. Vargu, në këtë pjesë të tij të dytë (si gjashtërokësh i dyzuem) asht mjaft i randë, i shkjeptë, s'e prekëm, për arsye rime.

3) Prift, që do t'u vejë kunorën, e cila, n'ato kohë, kishte ndryshe nga sot — randësinë kryesore.

4) Njani si korbi — i zi si korbi, për shkak të rrobeve të zeza, që ka veshë dhandërri.

5) Tjetra e bardhë porsi veza. Si në rrastin e parë, ashtu edhe në të dytin krahasimi ka të bajë me veshjen e dhandërrit e të nuses.



Tualet' i nuses: bukuri e madhe,  
Syrin e ka pishë, qafën si sorkadhe,  
Kurorën mbi vetull, vellon e zvarosur;  
Gra e burra prapa vijnë e s'kan të sosur;  
Zonjat alla braca 1), vajzat angazhe,  
Veshur jo më mirë, nisur pa hulé,  
Kapellat mbi sy, fustanet për tokë, 2)  
Të kuq e të bardhë me qilo, me okë 3).  
Kur kaluan krushkat, kundërmoi një erë,  
Er' e trëndafilit, e zëmbakut t'mjerë...  
Ububû zurnatë! Ciloja me shokë,  
Se po shpien nusen; vajzat kok' më kokë,  
Vajzat kok' më kokë, qeshin, kuvendojnë,  
Kur t'u dal' kismetit e kur t'i martojnë.

.....

... Gratë ven' përpara, burrat vijnë prapa,  
Në mes bien gazet, gjith' ecin me hapa,  
Gjith' ecin me hapa e dal' e ngadale,  
Shkojnë bulevardit, rrugës principale;  
Qosheve dëgjohen, fjalë dhe urime:  
— Aj, të trashëgohen, dhe në kokën time!

---

1) Të kapuna për krahu.

2) Asht fjala për modën e viteve '30. Fustanet ishin të gjata, saqë gadi arrinin në tokë.

3) Shumë herë, si edhe në këtë rast, Kapa do të ironizojë ato gra, që nisen e stolisen me tepri.

## REKLLAMË TABELLE 1)

Pazarit një ditë vetëm kisha dalë,  
Në disa tabella këndova ca fjalë,  
Këndova ca fjalë shkruar mir' e bukur,  
Të bëra me bojë, bërë për t'u dukur:  
«Çdo send prej floriri, qoft' i ri, i vjetër,  
Unazë dhe vathë, byzylyk' a tjetër,  
Blejmë dhëmbë ari, qostek' e gjerdhanë.»  
Kjo ishte reklama në sarrafët tanë.  
Myrafet i bukur, myrafet i mirë,  
E kuptojnë tjetrin, ku e ka fiqirë.  
Pse nuk i nxjerr dhëmbët e të vej' t'i shesë?  
Se i shkreti popull s'i bie hilesë,  
Se mund q'i ka mbetur ndonjë dhëmb në gojë,  
Q'është prej floriri dhe, kur ka nevojë,  
Ta çkulë e ta shesë për tri franga ar,  
Se këndon reklamat varur në pazar.

1) Kjo vjershë u botue në revistën «Rilindja», Korçë, viti I, Nr, 15, datë 6 Korrik 1935. E japim të plotë.

I mjeri njeri, q'e pret violia,  
 Ndalet i habitur: «Kam dhëmbët e mia»;  
 Shpejt dorën në gojë, që t'i kontrollojë  
 Dhe vete t'i nxjerrë, se më s'ka nevojë.  
 Ç'do t'i dua? thotë: kaloi ajo kohë...  
 Dhe në mos i paça, vall', kush do më njohë?  
 Po kur bën ta heqë dhëmbi s'çkulet lehtë,  
 Dara heq për poshtë, koka shkon përpjetë,  
 Dhe, i lebetitur nga dhëmbjet q'e zenë,  
 Po s'e çkuli s'ndalet, se ia bëri benë;  
 Barku thotë: «nxirre!», dhëmbi thotë: «s'dal!»  
 ...Ja bën qejfin barkut, dhëmbit nuk ia fal.  
 Pa le t'ketë bukë, pa s'ka ç'i do dhëmbët,  
 Siç nuk do këpucë për të mbathur këmbët.  
 Kur erdhi, me dhëmbë; — kur iku, pa dhëmbë,  
 Vajtj' e ardhje rrugën e bëri më këmbë,  
 Për çdo dhëmb nuk mori vetëm se tri franga:  
 Kaq i blen sarrafi sa ç'i blen dhe banka.  
 Do t'mos mbetet dhëmb, por as veth në vesh,  
 Do t'kesh mall të zgjohesh, do t'kesh mall të  
 gjesh.

Si nuk të sheh syri paren, që nuk vdes,  
 Lirat e Turqisë, flori me këndez,  
 Dhe gjerdhan' e gushës në gushën e çupës?  
 Po tashti sarrafi i mbledh e i tret,  
 Populli për bukë një nga një i shet.  
 Unazat me gurë, qostekët me lira,  
 Byzylykn' e dorës, vathët me inxhira  
 Dhe paran' e ballit të foshnjës motake,  
 Erdhi koh' e keqe, jetë varfanjake,

Me sa mall i shkreti e me sa rëzim  
 I dhuroi unazën nuses për kujtim!...

Dhe tashi nga gishti ia merr e ia shet:  
— Do krypë shtëpia, duhet bereqet!

Kush e bëri sefte, i ditur ka qenë,  
Që kurse ne dera reklamën ka vënë.  
I mbloodhi të gjitha, dhëmbë dhe qostekë,  
Populli ia shiti vetëm për çyrekë.

...Ja dhe un' i shkreti kam një dhëmb në gojë  
Dhe ia bëra benë. Kur të kem nevojë  
Do ta çkul pa tjetër; mir' po më kujtohet  
Sa vojta q'e vura; kurrë s'më harrohet...  
Kur më hiqte nervën e kur me ilaç...  
Ah! Saraf ç'më bëre, na, për atë paç!

## PAJA 1)

Te një mik në dasmë më ftuan dhe mua...  
Ua paça borç, ua paça hua:  
Dhe desha nuk desha, zonja më shtërngoi  
Një peshqesh t'i shpiem, se prandaj na ftoi.  
Vetë nuk u ndodha, zonja më tregoi,  
Q'i treguan pajën, kur vajti uroi:  
«Ç'të të them, or burrë, lum kush do ta marrë  
Pajën, që ka bërë; le q'e ka me barrë,  
Po dhe çfarë paje!... Ku mbaj mend dhe unë!...  
Çfarë s'kishte bërë!... Pastaj, çfarë punë!...  
E këto kuverta, kto «jirô» krevati,  
Kishte dhe qilime..., s'tregohet masllati.  
E këta jastekë: lloj-lloj, si t'i donje,  
Veç të ishnje vetë, me sy t'i shikonje!  
Pa le tapitarat, pa le kortinaqe!...

---

1) U botue në revistën «Rilndja», Korçë. Viti I, Nr. 16, datë 20 Korrik 1935. E japim të plotë.

Sadô të tregoj, do t'harroj dhe kaqe.  
 Pa le vogëlma: këmish' e zhilera...  
 E kto «niktikora»..., ku mbaj mënd e mjera,  
 Me kto të qëndisur si në figurinë,  
 Të gjitha me teste, po dhe me dyzinë.  
 Dy, tri bizhamara i kish bër' tenekos  
 Ç'të të them dhe unë!... Gjith' dyqan' i Shekos.  
 — Po bono nuk kishte, as dyshek, moj grua?  
 — Ç'të të them tashi, kur s'erdhe me mua!  
 Kush e ze bononë, kush e ze dysheknë?  
 Një maqinë vetëm nuk e ngre dot dengnë;  
 Të shihnje bononë, të merrte sevdaja,  
 Pa le gardiropnë nga fundi në majë,  
 Me këto pasqyra, me kto zografira...  
 Besonj kish kushtuar përmbi dyzet lira.  
 Të luan fiqiri, e ku nëmërohen?  
 Si lum ata djem, që tashi martohen;  
 Dhe iu nxifsha ditën atyre, që thonë:  
 Është kriz' e madhe ktu në vendin tonë.»

Gjith' kjo pajë a jepet? Vallë, kush ka faj?  
 A nuk ka faj çupa, nëna dhe babaj?  
 I shkreti baba, jep para për ditë  
 Të bënj çupa pajën, pa le pastaj prikë...  
 Ç'duhet gjith' kjo pajë e gjith' ky masllat?  
 Kush të ket' më shumë çupat vën' inat,  
 Çupat ven' inat e s'bëhen merak  
 Se sot s'ka fitime dhe babaj u plak.  
 Gjith' ditën i sheh qepin e qindisin,  
 Disa bëjnë jaka, disa zografisin,  
 Më nuk lanë penjë, s'lanë umaira:  
 Kto blihen me franga; prika është me lira.

Çupa merr me vehte, veç prikës dhe pajë,  
Ngarkohet maqina me kulm' e me majë,  
Me kulm e me majë te burri çngarkohet  
Njëri po çkatrohet, tjetri pasurohet.  
Katr' a pesë çupa një shtëpi të ketë  
Vall', sa pajë duhet?... Bëje hesap vetë...  
Lere pastaj prika, që duhet flori,  
Se, pa to, dhe çupën krye në shtëpi.  
...Prika është prikë..., pa le pastaj pajë...  
Ngarkohet maqina me kulm e me majë,  
Ngarkohet maqina plot me punë dore...  
Sa vall' kushtoi çupa, nga shpia, q'e nxorre?...  
Prindërve të shkretë më s'u mbeten rupa:  
Do qëruar plehu, do martuar çupa.

## MUHABET SOFATI 1)

Po shetitnja rrugës si i dembelosur,  
Në çdo prak e portë gratë qen' radhosur...  
Plaka rri tjerr leshnë me furk' e me boshte.  
Nga kujtim' i jetës nuseve iu thoshte  
Si shkoi çupërinë e si qe martuar;  
Sa vjet shkoi me burrën praknë s'kish kaluar.  
Vajzat i ven' veshin, qeshin, qesëndisin...  
Me kta llërë jashtë, me kta thonj me majë  
Qindisin e qepin, përgatitin pajë;  
Përgatitin pajë, borot plot i kanë,  
Po s'pat napolona, nuk ia kan' sevdanë.  
Kur mbaron së tjerri plaka mbështjell trembë,  
I ndihmon dhe vasha ndenjur këmb' mbi këmbë...  
Fillon muhabeti për miq e për shoqe,  
Dje a qe në kishë, kë pé e kë poqe,  
Kush, vall', paska lindur dhe kush qënka vluar,  
Kush u nda nga burri dhe kush qe martuar,

---

1) U botue në revistën «Rilindja», Korçë, Viti I, Nr. 20, datë 21 Shtator 1935, me pseudonimin Kapa. E japim me pak shkurtime.



Kush nuk shkon me vjehrrën dhe kush me  
kunanë

Dhe pas modhës fundit kush e kish fustanë...

— Ja, po vjen dhe Cilja nisur, pispillosur,  
Të bardhën që bleu nuk e paska sosur,  
I shkëlqen surrati, si një fletë kartë,  
S'ka turp dhe del rrugës; duke gdhirë e martë  
U kërlësh <sup>1)</sup> me burrin, sa u mblodh mëhalla:  
Kërkonte kapellë,.. s'i mjafton mësalla...  
Veç, kur kalon rrugës një me zarzavate,  
Kujtohet për darkë, ndryshe, shkoi e vate,  
Do shpifte, do thoshte: «Të keqen, o burrë,  
Sonte s'bëra gjellë, se kam qen' sëmurë.»  
Kur bien këmbanat për hesperinonë,  
Plakat zën' e falen, nuseve iu thonë:  
«Shko ndisni kandilë sa të mbanj' tër' natën,  
Nesër kemi kremte, i paçim uratën.

.....

... Sa din' e sa njohin s'lenë pa ngojosur, <sup>2)</sup>  
Ky lloj muhabeti kurrë s'ka të sosur...  
Muhabet i ëmbël, muhabet sofati,  
Goja s'u rresht kurrë, duart si sahati,  
Punojnë e nxitojnë në port' e në pragje,  
Gjith rrugët e Korçës me gra vargje-vargje.

---

1) u zu.

2) pa marrë nëpër gojë, pa shpërfolë.

## KATUNDARI NË PAZAR 1)

Dhjetë orë larg, ngarkuar hajvanë,  
Po vjen katundari që të shesë kanë;  
Kush ka prishur pendën, kush sjell bereqet,  
Kush vezët e pulat në pazar i shet,  
Kush një barrë dru, ngarkuar gomarë,  
Bën hesap t'i shesë dhe plaçka të marrë.

Pazar' i qytetit, pazar jahudiu, 2)  
Që të gjithë blejnë veç tek myshteriu,  
Ësht' mësuar këmba prej gjyshi, stërgjyshi:  
Ku ka lehur qeni, leh edhe këlyshi;  
Mirpo tregëtari s'ka din e iman,  
Kurse katundari është m'allalexhan.  
Një killë bereqet ngarkuar gomarë,  
E shiti dhe misrin, q'i duhej për farë.

---

1) U botue në revistën «Rilindja», Korçë, Viti I. Nr. 22, datë 19 Tetor 1935, me pseudonimin Kapa. E japim të plotë.

2) çifut.

Misri iu mbarua, si t'ia bënjë hallë?...  
I vjen mendja rrotull, qylafi vërdallë,  
Dyqanxhiut i ka, beut dhe ca më shumë,  
Po punion pa rreshtur, nuk mbyll sy për gjumë,  
Prap nuk ia del dot, se sot ndryshoi jeta,  
S'të ngreh bujqësia, kjo është e vërteta,

— Ngjat jeta, usta, e dyqan i mbarë...  
— Mbarë paç, mirse arhtë, rrini, pashallarë;  
A jini? si jini? — thot' afendikoi,  
Dhe me nënqeshje të gjith' i vështroi.  
— Si i kini hankot, bagëtin' e gjënë?  
Ç'na suallt' nga fshati gjesënd për të ngrënë?  
Kush i ka sjell zoga, kush vezë, kush pemë...  
— Kto janë peshqeshe, n'hesap nuk i zemë.

Tregëtari ynë, çifut Selaniku,  
Bujkun, katundarë, e ropi, e fiku;  
Me disa pallavra, me disa betime,  
Ankohet e qahet se nuk ka fitime;  
Se ka veresie shumra për të mbledhur,  
Prandaj nuk jep më, që kur ia kan' hedhur;  
Fundja, dhe n'i dhëntë, i merr një senet,  
Q'ia bën shitkë arën, me gjith bereqet.

M'ato pak të holla, nga plaçkat që shiti  
Nuk bleu as çereknë, nga ç'e porositi  
Hankoja 1) të blejë; nga t'ia mbanj' i shkreti,  
Kaq i bëri malli dhe kredî nuk gjeti.  
Kthehet nga pazari kaluar më njanë,  
Kurrë nuk e le pa hypur hajvanë;

---

1) Në kuptimin: grueja.

— Shti i shkret' — i thotë dhe ia merr një herë,  
Kshtu, duke kënduar, do harroj' qederë.  
Bar, elb e tërshërë, kafshës nuk i vuri,  
Në mos ect' i mjeri, pastaj lot dhe druri;  
Samar në mos pastë, zbathur në u ndodh,  
Ky ka hall' e tij, s'pyet në u lodh...

.....

... Kthehet me t'u ngrysur, me hejbe, me torba,  
S'merr asgjë prej gjëje q'i tha grua korba,  
Veç kryp' e piper dhe një rotkë penj,  
S'di ç't'i thotë zonjës e si ta gënjejë.  
Edhe, kur e pyesin: — Ç'kishte në pazar?  
— Ja, vajta me kal, erdha me gomar!>

## Ë N D Ë R R ! 1)

Pashë nj' ëndërr, sikur isha  
Deputet, cilindër kishja,  
Rëndësi të madhe mbanja  
Dhe çdo ditë mirrja banja; 2)  
Kur po vinja n'Parllament  
Kishte mbetur veç një vend;  
Kur fillova të humbesha,  
Fét! u zgjova!... U! Sa qesha!

Pashë nj'ëndërr, sikur isha,  
Deputet, cilindër kishja  
Dhe, kur ecia, ecja plogë: 3)  
Po përse? Xhepet me rrogë

---

1) U botue në revistën «Rilindja», Korçë, Viti II, Nr. 24-25, dt. 28 Nëntor 1935, me pseudonimin Kapa. E japim të plotë.

2) Vargjet 3-4 të strofës së parë kanë këtë kuptim: I jepja randësi të madhe vehtes, mbahesha me të madh, dhe çdo ditë bajshe banja.

3) Plogësht, randë, ngadalë.

S'më lejonin të nxitonja;  
Dhe, një mik, kur po kërkonja  
Disa fjalë do t'i thesha,  
Fët! u zgjova!... U! Sa qesha!

Pashë nj'ëndërr, sikur isha  
Deputet, cilindër kishja,  
N'Parlament me vrap arrita  
Dhe një fjalë pregatita,  
Si Baba i Kombit q'isha,  
Herë rrinja, herë ngrisha 1),  
Kur m'i zgjuar po rrëfsha, 2)  
Fët! U zgjova!... U! Sa qesha!

Pashë nj'ëndërr, sikur isha  
Pasanik, pallate kishja,  
Shërbëtorë me dyzina,  
Me fabrika, me maqina...  
Dhe në rrugë, kur kalonja,  
Më nderonin, nuk nderonja,  
S'më mungonte çdo, që desha.  
Fët! U zgjova!... U! Sa qesha!

Pashë nj'ëndërr, sikur isha...  
Dhe një titull Bej e kishja,  
Një çiflig, sa s'kish kufi,  
Unë e kishja me tapl...  
Bënja qejf e s'kishja fré,  
Shkonja jetën pa gajlé,  
Vrisnja, prisnja kë të desha,  
Fët! U zgjova!... U! Sa qesha!

---

1) Ngrihesha.

2) Po u tregoja.

Pashë nj' ëndërr, sikur isha  
Fukara, parà nuk kishja,  
Plot me halle, me qedere,  
Kishja qé, po s'kishja qerre,  
Kishja arë, s'kishja farë,  
Dhe më vinte për të qarë,  
Dhe më qe mërzhitur jeta.  
Fët! U zgjova!... Ashtu mbeta!

Pashë nj'ëndërr... S'di si e pashë...  
Që nga qielli mbi dhe rash,  
Vërtet lartër, po s'u vrash,  
Dhe me vehten time thash:  
«Ç'do të bënj këtu mbi tokë?...  
Kush ka pare, ka dhe kokë...  
E pse erdha m'u këndoftë?!  
Ah! Ç'u zgjova! Lanet qoftë.

Të mos isha zgjuar  
Do të qesh harruar.

## Ç'TË FLAS? 1)

Më kan' folur shumë, më kan' bër' taxhis  
Të mos flas për gruan, se më s'leverdis,  
Jo dhe si daullka, që mban një avas...  
Peqe, ja pushova! thuajm' ti ç'të flas?

...Të flas për bejlerët?... Më mir' ta mbyll  
gojën,

Mund që vjen një ditë t'ua kem nevojën.  
Sa për deputetët, të flas ose jo,  
«Pse e ke votuar, kur ti nuk e do?» —  
Do më thotë tjetri; tamam vallahí,  
Siç kam un' të drejtë, ashtu ke dhe ti.  
Të flas punë feje?... Zoti mos e dhëntë.  
Veç të jem i marrë, t'më ken' lojtur mëntë;

---

1) U botue në revistën «Rilindja», Korçë. Viti II, Nr. 24-25, datë 28 Nëntor 1935, me pseudonimin Kapa. E japim të plotë.



Është «Hyll' i Dritës» 1) gjithashtu dhe «Leka» 2),  
 Prandaj mbi kte çeshtje as fola, as preka.  
 Të flas për xhandarët?... Pupu! meazallah,  
 Në bëfsh ndonjë faj, ke të bësh me ta;  
 Dhe për taksidarë kurrë nuk do flas,  
 Se dhe ky xhandarë gjithnjë e mban pas.  
 Të flas për bakallë, që s'jep veresie?..  
 Shih se mori vesh, më ngriti padie...  
 E po për furrxhinë thua j'm' si të flas,  
 Veç të rri pa bukë, të nxjerr një avas...  
 Dhe për sinematë të duash të flaç:  
 «Shko në të pëlqeftë; mos ec në mos daç.» —  
 Kështu të përgjigjen; mund të ken' dhe hak,  
 Pse i *prish të hollat*, kur nuk je merak?  
 Po të flas për «Stamles-n», «Saiden»,  
 «Tomorë» 3)

*Gjith' duhan' e vendit kta e kan' në dorë;*

*Veç të lë duhanë, të mbytem në gjol,*

*Cigaret e tyre janë monopol.*

*Ashtu si për «Sita-n» 4) fjalë s'mund të thuash,*

*Se bukën pa krypë nuk mund ta gatuash.*

*Po për elektriknë, që ndrit kasabanë,*

*Si dhe për fabrikën, që ka atje pranë,*

*Në bëftë gabime, prap le t'i ujdisë,*

*S'është puna ime, i përket Bashkisë.*

---

1) «Hylli i Dritës», revistë e përmuejshme, organ i **Françsekanëve. Botohej në Shkodër.**

2) «Leka», revistë, organ i Jezuitëve. Botohej në **Shkodër. Shtypi demokratik i viteve '30 dhe disa nga shkrimtarët e rij përparimtarë t'asaj kohe polemizuen si me «Hylli i Dritës», ashtu edhe me revistën «Leka»**

3) Shoqni aksioniste duhani.

4) Shoqni aksioniste elektrikiu.

Dhe për birrën «Korça», birrë jo e lirë,  
Si ta zë në gojë, kur nuk e kam pirë?  
S'është për të folur, se mendjen ta humb..  
Pini që të gjithë, dehi, bëhi thumb.  
Të flas për revista, apo për gazeta,  
Se ç'kanë të mira, se ç'kanë të meta..  
Në thonjt e ndonjerës shiko se po hyre,  
Të shajnë e të fliqin, kan' veglat e tyre. 1)

.....

„ Dhe siç po e shihni, miq, hasmë, sa jini,  
Kur shahem me gruan, mëri mos më kini;  
Të shkruaj mi punët, që ngjasin në botë,  
S'më duket e udhës, më duket e kotë,  
Të flas për të tjera më ven' në qymes:  
Un' e di proverbin: s'hyn' prifti në thes.

---

1) Aluzion për shtypin zyrtar e klerikal, që sulmon-  
te shkrimtarët e publicistët e rij përparimtarë.

## KANDIDAT PËR DEPUTET 1)

Kam mbetur pa punë, vaj medet për mua!  
Po kam dhe familje, kam një lanet grua;  
Natën nuk kam gjumë, mëndja m'vjen vërdallë,  
Nuk di nga t'ia mbanj e kujt t'i qanj hallë.  
E ç'zanat të zë?... Të gjithë s'punojnë...  
I ka kapur kriza, asgjë nuk fitojnë.  
Ç'zanat është m'i mirë, vallë, kush e di,  
Që s'do kapitale, s'do as mjeshtëri?...  
Veçse deputet, tjetër gjë nuk mbet:  
Ngado t'i kthesh sytë të duket qamet.

S'ka si ky zanat asgjëkund mbi dhét,  
E ke fjetur mendjen plot për katër vjet;  
Dhe, në Parlament, po zure një fron  
Del dhe tjetër herë, se bëhet zakon;

---

1) U botue në revistën «Rilindja», Korçë, Viti II, Nr. 31, Datë 7 Mars 1936; me pseudonimin Kapa. E japim të plotë.

Zori është sefte, sa të futësh këmbët,  
Rri, po fute këmbët, sa të bien dhëmbët.  
Dhe, në thënç, zotrote, se ka punë shumë,  
Kur flasin të tjerët flij, merrja me gjumë,  
N'u vëntë në votë, fundja më në fund,  
Shokut që ke pranë i thuaj: «më tund,  
Or koleg të lutem, pa, kur të flesh ti,  
Do t' të zgjoj dhe unë; se, sikundr' e di,  
Dëgjoke, s'dëgjoke, kjo nuk ze mazi,  
Gjashtë muaj gjumë, gjashtë muaj rri...

Në një shkollë nate që tashi u shkrova,  
Me korespondencë mësimet fillova  
Te Universiteti i Deputetërisë  
Dhe t'i sjell shërbime atdheut, Shqipërisë;  
Për tre, katër muaj do marr një diplomë,  
Siç marrin studentët në Pariz, në Romë.

Kur të vinjë koha, do bënj propagandë,  
Do marr një daulle, në mos gjeça bandë,  
Do mbanj dhe një fjalë përpara miletit,  
T'u shpegonj mbi themën: «Vot e Deputetit»,  
Do nxjerr dhe gazetë, nga më të mëdhat,  
Kur të vinjë koha, do hap një fushatë,  
Se nuk është e udhës, është një mëkatë  
Të votojnë burrat, mos votojnë gratë. 1)

Po kjo pun' e rrogës s'para çon kandar,  
Se kjo është e sigurt q'unë do ta marr;  
Dhe do t'u jap fjalën e do t'u bënj bé:  
Do t'i ndanj në popull... me ca pak fajdé.

---

1) Poeti tallet me deputetët zogistë, që, në fjalimet e tyre, para zgjedhjeve, bajnë premtime «liberale» për qëllime demagogjike.

Pra, sikundr' e shihni, do bënj mjaft të mira,  
Të ma hidhni votën, n'u bëfshin të lira;  
S'jam sidokudo, as analfabet,  
Prandaj e vendosa të dal Deputet.

... Kishja një andrrallë, ishja në merak,  
Se ishja pa punë, mbetur në sokak,  
Tani do ndjek shkollën, që nxjerr deputetë,  
Kur të vinjë vjeshta, kandidat dhe vetë,  
Do më dalë emri shkruar me mellan,  
Për të gjithë botën Zoti bën derman.

## KATUNDARI NË QYTET 1)

Ngarkuar gomarë po vjen që nga fshati  
Dhe shportën me vezë dhe pula në pati,  
I sjell që t'i shesë një ditë pazari;  
Nuk ish as i fundit, nuk ish as i pari,  
Që s'kish dhe opinga, as gunë shajaku,  
Po vuan dhe djali, siç vojti dhe plaku.  
S'i mbeti gjë tjetër të shkretit fshatar.  
As kal e as mushkë, po veç një gomar,  
Dhe penda e qeve, edhe një dhi shytë,  
Prandaj po i ruan, siç ruan' dy sytë.  
Kush, vallë, ia ka fajné? As ky nuk e di,  
A, vall', t'jenë njerës, t'jetë Perëndi?....  
Kshtu ish shkruar fati dhe nuk nxjerr as zë,  
E mban kokën unjur dhe nuk kërkon më.  
Kur ky, me gomarë dhe dalëngadalë,  
E arriu qytetnë dhe atje u ndal.

---

1) Botue në revistën «Bota e Re», Korçë, Viti I, Nr. 1, Datë 15 Prill 1936 me pseudonimin Kapa. E japim me pak shkurtime.

Pa njerës të veshur: me rroba, këpucë...  
Sheh këmbët e tia.. I kishte në lucë.  
Dhe tha me të drojtur: «Eh! atje u qoftë!  
Sa tremben nga smundja; kshtu njeriu mos  
rroftë.

Por pa dhe pallate: me gurë, me bojë...  
E hoqi dhe pipën, që mbante në gojë  
E kujtoi kaliben: pa oxhak, pa derë,  
Ku shiu dhe dëbora nuk e lën' të flerë...  
Dhe mbet i mahnitur... Kur një zë pa pritur:  
«Sa iu kërkon druve, apo i ke shitur?» —  
I thirri që prapa. — Jo, or zotëri,  
Tri leka më dhanë..., në daç... merri ti.

.....

Pa dhe djem të vegjël, një sa djalë i tia,  
Që vdiq atij moti, nga smundja.. uriya!  
Pa dhe kafenera, ku po pinin birrë  
E plot me mezera, qejf s'bëhej më mirë...  
Iu kujtua dasma, q'ishte bër' në fshat,  
Kur ngrinin dollira, pinin me inat.  
Pa dhe bukë furre... S'ish si buk' e tia;  
Kur e pa të ngrohtë, e mori uriya;  
Nxori misërniken, që kishte në torbë,  
E kafshoi dhe tha: «Ah, moj botë korbë!...»  
Pa dhe gazetë 1) me mall, ç'tyrli malli:  
Ku gjëra për veshje, ku sende bakalli;  
Ky si mos më keq, gjysm' opinge mbathur,  
Dridhej nga të ftohtit, e po ecte zbathur,

---

1) Magazinat.

Kur ish plot këpucë dyqan' i esnafit...  
Po, kur pa paratë në mostr' e sarrafit,  
U mahnit dhe tha: «Do vete t'i marr!»,  
Ktheu kryet prapa dhe pa një xhandar..  
Shpejt e mbloodhi vehten dhe shkoi te nallbati  
E mori gomarë... u nis për nga fshati.



## EPITAFI I REVISTAVE 1)

Doli 'i herë, në vaht — hile  
Me pak dahtë si kandile  
Një revistë kulturele,  
Që përshkoi fusha dhe male;  
As xhenemi mos e qastë,  
Quhej «Flaga», ndjesë pastë!  
Nejse, shkoi, ashtu si shkoi,  
Me tre numura mbaroi.  
Tha të pillte, po dështoi;  
La fëmijët nëpër udhë,  
Të parritur, si kërpudhë.

Doli «Jeta e kultura»,  
Kish të rinj e kishte burra,  
Gjith' të pjekur nëpër furra.  
Vdiq e mitur, e parritur,  
Veç tri numura kish shitur.

---

1) U botue në revistën «Bota e Re», Korçë, Viti I, Nr. 2, Datë 30 Prill 1936; me pseudonimin Ras-i. E japim të plotë.

Dhe, kur doli «ABC-eja»,  
Me lezet, si gratë e veja,  
Shpejt e shpejt e hop e hop  
Më një numër bëri stop.

Po «Rilindja» u përpoq,  
Më tridhjet' e dy... u doq.  
Tashi doli «Bot' e Re».  
I ka venë vehtes fré,  
Që të mbyllet nuk ka nge,  
Se, siç thonë ata q'e kanë,  
Me peshim pagoi qiranë.

## KUR TË HAHET HAKA 1)

Sot jam i gëzuar, si do vetë Zoti, 2)  
Se puna, që bëra s'më vajti së koti.  
Vërtet se harxhova dhe ca pak pará,  
Por hakën e mora, fitova davá  
Dhe një batakçiu, që desh më gënjeu,  
Një vendim i gjyqit gjith' shpresat ia preu.  
Ja, si qëndron puna, thoni se s'kam hakë:  
Kishja gjashtë muaj, q'isha në merak:  
S'ka njeri pa halle, veç Zoti ia di,  
Kishja ca të holla, alltén-parasí  
Nuk dinja ç't'i bënja, i dhash' me fajdé  
Dhe t'isha i sigurt, mos kisha gjallé,  
Ky m'i bëri shitkë shtëpi, ara, që,  
Gjithë bagëtinë dhe më bëri bé

---

1) U botue në revistën «Bota e Re», Korçë, Viti I, Nr. 3, Datë 15 Maj 1936, me pseudonimin Kapa. E japim të plotë.

2) Vjersha asht shkruar në formën e monologut të një fajdexhiu.

Nga njëqind q'i dhashë, këtu e motmot,  
Dyqind të më jepte... Po s'i bëri dot...  
T'ia merrnja të gjitha ç'kish e nuk kish!...  
Pa më dha dhe fjalën... asnjë dhjeç mos prish,

Shkoi gjysm' e vadesë; m'i pagoi njëqind,  
Ndrroam dhe senet e e bëm' dyqind...  
Nuk i pata faj; ah! e zëntë buka,  
Vajti mori mëndje nga disa kopuka,  
Pa vjen e më thotë: «Dale-or zotëri,  
Gjysmat t'i pagova, ç'të mbeta tani?»  
Të mirën, q'i bëra aspak nuk ma di,  
Vjen e kundërshton, si një çilimi.  
Pa fjalët e tia i vanë së koti.  
Se unë ç'i bëra...? Me të shkuar moti,  
Me senet në dorë... në prokurori  
Dhe ia marr të gjitha: shtëpi, ara, dhí  
E ç'kish bagëti, — sikur qe seneti,  
E ta flaka jashtë: ishte vet' i teti!...

.....

... Mir' iu bë qafirit, atij bataçiu,  
Ishte një gjakpirës, s'kishte shpirt njeriu,  
Desh të haj' paratë, ah, iu nxiftë nuri!  
Atë kokë pati, atë feste vuri!

## PA GAJLE, PA HALLE 1)

Parësi e vendit pa gajle, pa halle,  
Në sallë lluksoze venë lozin valle,  
Venë lozin valle, zbavitën, dëfrenjë,  
Pa dhe botës tjetër vetë i rrëfejnë  
Si lohet tangòja, si lohet foks-troti,  
Jo më devolliçe, jo valle qëmoti;  
Si e mbërthen djali të bijën e botës;  
Të ngrihen përpjetë dhe qimet e kokës,  
Ç'është politesa, ç'është etiketa,  
Si serviren pijet, kur ndodhen dy veta...  
Burrat në të zeza, gratë ngjyra-ngjyra,  
Si xhame kristali u shkëlqen fytyra.  
Me një vrap të gjithë: burra, gra e ç'janë,  
Vetëm të dëfrenjë, tjetër mëndje s'kanë.  
— Ububu, sa bukur, sa lezet moj xhane,

---

1) U botue në revistën «Bota e Re», Korçë, Viti I, Nr. 5, Datë 15 Qershor 1936, me pseudonimin Kapa. E japim të plotë.

Kur këmbët e djalit pshtillen me fustane!..  
Dhe kta sazexhinjtë, bijt e racës tjetër,  
E lanë mbasdore melodin' e vjetër,  
Por kohë më kohë ndërrojnë avas,  
Herë ia marrin unjtër, herë e kthejnë xhas.  
Kur, të dehur, çiftet nuk gjenë derman  
Shpejt dhe muzikantët e bëjnë duman.  
Kërcasin shampanjat, tapat në tavan...  
Ku je zengjinllëk, jetë pa katran!..

Patë, u kënaqtë, mjaft tashti dëfryet,  
Me ahenk të kotë sytë i gënjyet...  
Pa zbrisni nga kali, shihni atje tej  
Popullin, që vuan e që s'rron, si bej;  
Ja: mizat e dheut, shihni, o gjinkalla,  
Ai kërkon bukë, s'ngopet me përralla.  
S'ngjinjet as me afshin e tryezës suaj...  
Me që s'ish në ballo, për ty është' i huaj...  
Jo, nuk është' i huaj, është' vëllai yt.  
Kur ti pi shampanjë, si, vallë, s'të mbyt,  
Kur i bir' i botës me një rreth fëmijë,  
Qan e lebetit dhe s'guxon të vijë  
Të të ndehë dorën ty — një parallí,  
Që me djers' të tia ke vënë flori?...  
Po, kur mbushet kupa me vojtjet e tia,  
As nga ti s'do ndihmë. as nga Perëndia...

.....

... Nejsë, ç'ka të bënjë? bota kshtu u end,  
Kush parà na paska, paskërka dhe mend.  
Pra, le të dëfrenjë dhe të hedhë valle  
Parësi e vëndit, pa gaile, pa halle!..

## TITUJ FISNIKËRIE. 1)

Nakatoset puna, përzihet mileti...  
Kujt i ra ndër mënd dhe kush vallë e gjeti,  
Që ka çpikur tituj soji, mjeshtërie?  
Apo mos ka qenë urdhër Perëndie?...  
Titull, mor jahu, nuk ke se ç'i thua,  
Dhe s'ka qenë kurrë si ti e si mua.  
Kështu çquhet tjetri, si dhija nga dhentë,  
Se kandar nuk kemi të zigjasim mëntë...  
Porsi amëshori, pa fre e pa shalë,  
Në çdo vend që ndodhet guxon e merr fjalë  
Dhe veprat e tia kanë plot sukses:  
E luajn' verdhushkat rolin në kte mes! 2)  
Shih, .beu nga harbuti njihet jo më mirë:  
Njeri rron pa lodhur, tjetri që pa gdhirë

---

1) Û botue në revistën «Bota e Re», Korçë, Viti I, Nr. 6 Datë 1 Korrik 1936, me pseudonimin Kapa. E japim të plotë.

2) Asht paraja ajo, që i ban të fuqishëm, u jep randësi.

Vete lëron tokën e punon si derr  
Dhe hakën e tia kurrë nuk e merr.  
Dhe, në rast se ndodhet ndonjë kavaljer,  
Mos e prishni gjaknë, mos kini qeder,  
Se janë të rrallë, vetëm sa për mall,  
Si gurë xhevairi, që ndritin në zall.  
Rroba bën uratën, titulli njerinë,  
Në parat' e thata dallojnë sojllinë 1)  
Siç dallohet plaku këmbëkryq në këndit,  
Koburja me sërmë bajraktar' i vendit.  
Si beu, si arhondi, njëlloj e jo ndryshe,  
Ca gala, ca korba, as një dallëndyshe;  
Që të dy të lodhur e të raskapitur,  
Me djersën e bujkut tokën kan' vaditur!

Çdo njeriu të pasur e që ka të holla,  
Në shtëpin' e tij' nuk i ngjiten njolla,  
Nuk i ngjiten njolla, jo, fisnikërisë,  
Të zi e ka gjaknë, si katrani pis,  
Pa dhe brez pas brezi dhe nip e stërnip  
E çmonte dhe shteti, e bënte qatip,  
Se një der' e madhe, një shtëpi oxhaku  
Lind dhe djem të ditur, si ç'ka qen' dhe plaku;  
S'ka si bëhet ndryshe, se i caktoi fati...  
Harbuti sojsës pëllcet nga inati;  
E ka kot, i shkreti, sojlliu po sojllí:  
Mëri mos ia kini, kaq bën e kaq di...

.....

... Titujt, kur u ndanë, një pakicë zgjodhë,  
Shumic' e milletit atje nuk u ndodhë,  
Ca e blenë shtrenjt..., ca e ngjitrnë vetë,  
S'është faj' i tyre, faji është' i shkretë.

---

2) Njeriun. e fismë.



## PËR SYT' E BOTËS 1)

Bota është' e ndarë në meshkuj dhe femra,  
Dhe ndarjet e tjera kanë lloj lloj emra,  
Nuk ka kush të thotë se jan' barabar,  
Ja, dhe seksi seksit i ha në kandar...  
Të mos shkojmë tutje, flasim ktu ku jemi,  
Pasqyrën e jetës përpara e kemi:  
Shiko bulevardë: duket një ujëm,  
Me gra dhe me burra, me vajza, me djem;  
Kanë duf për qejfe, prirje për liri,  
Më nuk rrinë mbyllur, kyçur në shtëpi,  
Dhe, për syt' e botës, syt' e jabanxhiut,  
Duket në një shkallë jeta e njeriut.  
Po, kur ia ve veshin, kupton një kufi:  
Kushdo me familjen, me njerzit e tij...  
Ahere dallon dy kampe të ndarë...  
Ku është zhvillimi, që jeta ka marrë?

---

1) U botue në revistën «Bota e Re», Korçë, Viti I, Nr. 8, Datë 30 Korrik 1936, me pseudonimin Kapa. E japim të plotë.

Veç pak përparim në vatër, në shpi,  
Përjashta nga pragu asnjë shoqëri.  
Lluksi, tualeti të rren, të gabon,  
Se mendja dhe jeta të vjetrat vazhdon.  
Gratë marrin poza, japin nënqeshje,  
Burrat mund të marrin nga një çmim në veshje,  
Dhe jo më gjë tjetër... N'u hapt' bisedim  
Femra e mbyll gojën, mashkulli më trim  
Çfaq ndonjë mendim. Po kur flasin modhë,<sup>1)</sup>  
Të lenë pa veshë, sa zonja q'u ndodhë.  
Kur qëllon bidesa: Evropianizmë,  
Shpejt ta sjellin shëmbëll gruan, si konizmë;  
Për emancipim s'u pëlqen mendimi,  
Se e marrin gruan veç si mjet dëfrimi.

.....

... Ç'më gënjen mendja, deh, sa larg kalovë  
Dhe jetën e sotme desh e kritikova...  
Harrova i shkreti, sot s'jam barabar,  
As meshkujt e gjallë, as ata në varr,  
Kurse femrat tona janë shumë larg,  
Ndonëse shetitin rrugës varg e varg.  
Po, kur të vij' radha dhe për gjysmat tona,  
Do t'i bëjmë shoqe, s'i duam kokona!...

---

1) Por kur flasin për modhën.

## VRAHU DUHET HEDHUR 1)

Muajt e beharit, e nxehta me saç,  
Piqet buka vetë dhe bëhet kulaç.  
Drapëri e kosa korrin e s'pushojnë,  
Me duaj kallinjtë në lëmenj i çojnë  
Dhe rreth strumbullarit kuajt me gulçim  
Shijnë bereqetin shpejt e me nxitim...  
Se, ja, po vjen beu, vjen afendikoi,  
Do hakën e tij, — o lum' e përroi, —  
Do hakën e tij, krejt bashin e grurit,  
Jepja, se s'i bihet dot me kokë murit...  
Mbushi ujë taze, pregatiti drekë,  
Ca vezë, ca zoga dhe dy-tre byrekë,  
Se ka etje shumë, pa ka dhe urí  
Dhe ka prishur gjumin e mbi fshat u gdhi,

---

1) U botue në revistën «Bota e Re», Korçë, Viti I, Nr. 9, Datë 15 Gusht 1936, me pseudonimin Kapa. E japim të plotë.

Vrahu: asht fjala për ndamjen e grunit nga byku.

Se sot shtrohet lëmi, se sot hidhet vrahu:  
— Puna e mbarë, o bujqër, eh! ju lumtë krahu!..  
— Mirseurdhërove të paçim me jetë,  
Që more zamet dhe u lodhe vetë.  
Dhe me temenara dhe me politesë  
Të zotn' e çiflikut mundohet ta presë,  
Mundohet ta presë, për një i jep pesë,  
Se e flak dhe jashtë, pa e le të vdesë...,  
Pa e le të vdesë me gra e fëmijë,  
E ka mall' e tij, keq përse t'i vijë?  
Puno pa pushuar, lëro e rëmih,  
Me gra, me fëmijë, coptoju, dërsi,  
Dhe fundi, së fundi ç'ke nxjerrë në shesh?  
Ha bukën pa krypë, për gjellë s'ke presh:  
Banesë kasollen, pa rroba në trup  
Dhe je i fuqishëm, mban botën në sup..

.....

„ Muajt e beharit, e nxehta me saç,  
Qëndro pak në diell, në daç të pëlcaç;  
Po puna do bërë, vrahu duhet hedhur  
Dhe gjith' bereqeti nga fusha do mbledhur.

## TA GËNJEJMË VEHTEN 1)

Bota u ndryshua, s'është si më parë,  
Do ndryshonj dhe unë, se mos vijë mbarë,  
Dhe sendeve t'gjalla, gjërave t'shtëpisë  
Do t'u vë ca emra, siç të leverdisë.  
Pos kësaj, t'u themi, hakën mos u hamë,  
Gomarit: *veshgjatë* dhe hankos: *madamë*;  
Kaliben me gardh, mbuluar me kashtë,  
Do ta quanj *vilë*; kush do hyj', në dashtë,  
Do të shohë mbrenda kandilen, që ndrit,  
*Plakën e pangrënë*, që në kënd dremit,  
Dhe, kur qëndron zgjuar, nuk ka hi në vatër,  
Mallkon Perëndinë pse punoi me hatër..  
Do t'i them rrogosit, jastekut me kashtë  
*Je krevat me susta, pshtetje e mëndafshhtë*.  
Misrin e pagzova: një *kokërr-flori*,  
Piperë dhe krypën: *barut e inchi*...

---

1) U botue në revistën «Bota e Re», Korçë, Viti I, Nr. 10, Datë 30 Gusht 1936, me pseudonimin Kapa. E japim të plotë.

Gunën... gunë s'kemi, as këpucë jo,  
Potinat e këmbët na u bën' shevrò;  
Në vend të këpucës, çdo muaj të stinës,  
I mbajmë në këmbë rrotat e maqinës, 1)  
Rrotat e maqinës, palltot askerie,  
Poture shajaku, çorape prej dhije,  
Kësulën' më kokë dhe qesen në qafë,  
Çuditen dhe hallku, tmerohen sarafë,  
Se e ka japinë dyzet endezeé...  
Mos pyet ç'ka brënda..., i numro më nge-  
Sheqerin, kafënë, si lesht e devesë, 2)  
Në katund s'i gjeni, dhe në vrafshi pesë!...  
Në mbeti gjësendi pa zënë në gojë,  
Le t'i verë një emër, gjithkush, si të dojë:  
Fjala vjen, kopësë me dele, me dhi:  
*Kafshët e një cirku mbyllur në kuti.*  
Tamam kshtu kan' mbetur, si lopët dhe qetë-  
Dhe pulat, këndeizat: zoq, që rrin' mbi retë..

.....

Gjërat t'i ndryshojmë, emrat t'i këmbejmë,  
Si sytë dhe veshët sa mund t'i gënjejmë;  
Se ndryshe s'i delet, si arriu zamani;  
Filloni të qeshni, kur ju vjen të qani!...

---

1) Opinga me gomë.

2) Ashtu si edhe leshin e devesë (që s'e gjenin).

## KANDIDAT PËR DEPUTET 1)

Dikur ju kam thënë, popull e milet,  
Se dhe un' vendosa të dal deputet,  
Se dhe un' vendosa dhe i dhash' karar,  
Veç rrogës së Shtetit, tjetër gjë mos marr...  
Kur ta sjellë rrasti, të ketë lezet,  
Të mos ju prish qejfin, pranoj dhe ryshfet...  
Andralla në paçi, punëra në kini,  
Do caktonj orar në shtëpi të vini;  
Në sjellçi me vehte dhe ndonjë bakshish,  
Frikë të mos kini, se kjo nuk na prish.  
Por të mos gaboni, fjalë mos më thoni,  
Po s'dhat' nën dorë, punë nuk mbaroni:  
Jo se dua unë, por kshtu është' zakoni:  
Çdo mendim paguhet, kte mos e harroni.

---

1) U Botue në revistën «Bota e Re», Korçë, Viti I  
Nr. 11, datë 15 Shtator 1936, me pseudonimin Kapa. E  
japim të plotë.

Vetëm më jep votën, pastaj mëndjen flije,  
 Se un' jam pajisur me kultur' e dije  
 Dhe kam rresht dy muaj që po praktikonj,  
 Që gishtrinjt e dorës shpejt e shpejt t'i çonj,  
 Ç'gjë të paraqitet të di ta votonj,  
 Zoti mos e dhëntë që ta kundërshtonj!...  
 Një ish-deputet, po më jep «privat» 1)  
 Si duhet të sillem, fjalët si t'i mat  
 Dhe ç'ilaç do marr të më zërë gjumi,  
 Kur do bisedohet moratoriumi... 2)  
 Kam dhe një program, s'jam sidokudo,  
 Pastaj, kam dhe shokët ashtu siç i do...  
 Kur të vinjë koha, ja ku lë një shteg  
 Ta paraqit listën cilin kam koleg.  
 Zanatin që zgjodha e kam për sevda,  
 Kush nuk ma jep votën do jet' maskarà  
 Dhe, t'ju them të drejtën, t'ju kandis më mirë,  
 Kini koh' akoma ta mblidhni fiqirë 3)...  
 Jo me fjalë boshe, jo llafe të kota,  
 Por çdo gjë me rregull, të çuditet bota,  
 Të çuditet bota, t'habitët miletë,  
 Të gjith' të thërresin: «Rroftë deputeti!»

---

1) Po më jep mësimë private.

2) Falja e borxheve.

3) Ta mblidhni mendjen.



## INTERVISTË ME DOKTOR KAVALIERË 1)

Dëgjoni, o popull, vini vesh milet,  
Ju të gjithë e njihni doktorë që flet,  
Se ky ka vendosur të dal' deputet,  
Dhe bota të priset, të bëhet qamet.  
Me kavalierë, që mban dekorata,  
Në kohën e fundit intervista pata.  
Fort i begenisur Doktori bujar,  
Veç nga Ideali ka mbetur beqar.  
Ka vjetë i shkreti, që mundohet bosh,  
Vetëm se me fjalë nuk harxhon një grosh.  
Kryetar »Opinge«, shpirt aristokrati,  
Të gjithë e luftojnë vetëm nga inati...  
— Doktor i dëgjuar, më t'u shoftë nami,  
Mos të vdektë shpirti, mos t'u trettë dhjami,  
Më thoni. ju lutem, me ç'program do vini,  
Si do vepëroni, fuqi po të kini?

---

1) U botue në revistën «Bota e Re», Viti I, Nr. 12. datë 30 shtator 1936, me pseudonimin Kapa. E japim të plotë.

(Dhe kavalieri, me fjalët e arta,  
M'i radhit të gjitha, siç i thotë karta):  
— Të mirat e mija nuk maten me kut,  
Punët që do kryenj nuk do ken' hudut; 1)  
Sefte bujqësinë, pastaj tregëtinë, 2)  
Do t'i thanj dhe gjolet, do shtonj bagëtinë,  
Borxhet do të falen, siç thotë Soloni,  
Vetëm tetë orë ditën do punoni;  
Puna do të shtohet, rroga do madhohet,  
Do t'i ve në rregull, njeri mos ankohet.  
Dhe me gjith' këte nuk do kem mëshirë,  
Prandaj e theksonj, që ta dini mirë,  
Se me «pothen esqes» do ve një kontroll,  
Jo disa të vdesin, ca të kenë boll...  
— Tamam, ke të drejtë, por ç'është' e vërteta...  
— Lermë të mbaronj, more t'u ngjat' jeta,  
Un' e kam të gjithë popullin me vehte,  
Punoj për «Opingën», nuk punonj për vete.  
— Po ti s'mban opinga, s'mban as fustanella...  
— Sot ka ardhur koha që ka nder kapella;  
Jam një liberal dhe për feminizmë,  
E dua çdo punë oksidentalizmë.  
— Po...  
— Dale, prit, dëgjo, shëno:  
Do t'i djek senetet, do var fajdexhinjtë,  
Do t'i shtyp të vjetrit, do përkrah të rinjtë,  
Dhe shëndetësinë e kam për të bërë  
Të mos ketë vdekje pa koh' e pa sërë...  
— I vyer Doktor, as aman një llaf,  
Folmë pak më shtruar, folmë si esnaf,

---

1) S'do të kenë kufi.

2) Së pari do të rregulloj bujqësinë e pastaj tregëtinë.

Si do bëhet kriza...

— Kriza do varroset,

Unë do përpiqem misri të mos soset,  
Hallku të punojë dhe të çallëtisë,  
Taksa të paguaj' sa t'i leverdisë...

.....

.. Edhe shum' të tjera, që më tha Doktori,  
Desha që t'i shkruanj, vendi nuk m'i mori.  
Mbeta i mahnitur nga fjalët e zjarrta,  
Kot e akuzojnë: «I ka mënt' e tharta!»

## TABLLORA TË JETËS 1)

Ja, dhe vjeshta, shok' e miq,  
U mbarua, shkoi e vdiq,  
U mbarua, shkoi e vate,  
Erdhi dimri me inate;  
Erdhi dimri me dëbora,  
Do ta zbardhë, ta bënj' fora...  
Kush ka pare, metelikë,  
Bën dhe pallto me kozhuk,  
Nga e ftohta nuk ka frikë.  
Mban dorashka me pambuk.  
E ka pupa, e ka pikë,  
Në gllanik zjarri vërgë,  
Mbi këpucët mban llastikë  
Dhe çdo punë e ka më te.  
Zahire. ç'i deshi xhani.  
I ka blerë që vaft-ile 2),

---

1) U botue në revistën «Bota e Re», Korçë, Viti I, Nr. 16, Datë 30 Nëntor 1936, me pseudonimin Kapa. E Japim me pak shkurtime.

2) Që me kohë.

Gjellën taze nga tigani  
Ia bën hazër një kopile...

\* \* \*

Në një qosh me një shtëpi,  
Q'e mbulon një cop' çati,  
Nj' urë zjarri po tymos,  
Ca jetim' e një e vé,  
Hall' i tyre nuk u sos  
Dhe njeri nuk i ve ré.  
Rroba s'kanë, cop' e trokë,  
Barkun bosh, si tamburà,  
Për të gjith' punon një kokë,  
Duke lypur sadakà...

\* \* \*

Në katund, një bujk i ngratë  
Punoi tokën pa hilé,  
Tash i ka hambaret thatë,  
As për kafshët zahiré,

\* \* \*

.....

## PLAKU DHE I RIU 1)

Ishte natë dimri... Natë, çfarë natë,  
Jo me kut e metro, me tërkuz' e gjatë;  
Dhe në ishim mbledhur, bënim muhabet;  
Kish dhe nga të rinjtë, kish dhe burra pleq;  
Dhe kushdo dyzenit me avaz' e tia...  
Ja, disa mendime, që shprehte rinia:  
— E keqe kjo jetë, jallane dynjaja,  
Fryhet pasaniku, thahet fukaraja;  
Kto janë dy botë me gjëra të gjalla:  
Njeri e bën punën, tjetrit i pret palla.  
Një i falet Zotit dhe tjetri parasë;  
Kush, vall', ka të drejtë e kush do humbasë?...  
Fund' i meselesë dhe fund' i belasë;  
Paraja çall luftë popullin të vrasë,  
Kur ballë për ballë u bëhet përpjekja:

---

1) U botue në revistën «Bota e Re», Korçë, Viti I  
Nr. 2, datë 30 Prill 1936, me pseudonimin Kapa. E  
japim të plotë.

Njerit i qesh fati, tjetrit i qesh vdekja;  
Kështu është' e shkruar, kështu është' e thënë  
Thonë njerëzia, ata mëndjelenë...

Jo, nuk ështëë fati..., po je ti e unë,  
Që jemi verbuar e jemi për gjumë,  
Se nuk hedhim sytë të shohëm më tej  
Dhe ta gjejmë fatin, siç e ka çdo bej...  
Më s'na mban me shpresë jet' e amëshuar,  
Fund' i rruzullimit ktu duhet kërkuar.  
Në botën e vdekur, plot helme, siç rrojmë,  
Të çpallim të drejtën dhe jetën ta çmojmë;  
Se s'humbi gëzimi dhe shoresa e saj,  
Jo t'ia krisim kujes me lotë, me vaj...

Ndenjur pranë zjarrit, unjur pas oxhaku,  
Me çibuk në gojë, zu të flasë plaku:  
— Djemt e mij të dashur, djem si gjeraqinë,  
Rrofshi e gëzofshi, e shtofshi shtëpinë;  
Bosh që vrisni mëndjen dhe flisni së koti,  
Po dëgjoni mua, se jam plak qëmoti:  
Kshtu ka vajtur bota një puno, një ha,  
Njeri lëron arat, tjetri bej, pasha,  
Me kalë me shalë, me shtëpi pallate,  
Me shkallë mermeri, la tri-katër kate;  
Plot me shërbëtorë, plot me qehallarë.  
Kur të vinjë lëmi bereqet të marrë,  
Pula, vezë, shqerra, e ksish vogëlime,  
Veç q'i do pa tjetër, po do dhe nderime,  
Po dhe temenara dhe sjellje të mira,  
Se ka mall' e tia, e ka me tapira;  
E ka me të shkruar, me vula dovleti,  
Dhe ia din' të gjithë, pa ia di dhe shteti;  
Që kur u lind gjyshi, ia kish falur Zoti,  
Që kur u nda toka... prej shekujsh qëmoti...

... Ky qe bisedimi rrethqark gllanikut,  
Në një natë dimri, në shtëpin' e mikut,  
Dhe në mendjen time një pyetje mbiu:  
Kush kishte të drejtë: plaku a i riu?



## PO KËRKONJ ILAÇ 1)

Më zuri një smundje, fort u leqendisja,  
Dhe botën e tërë për ilaç gjezdisa,  
Vajta e ku s'vajta, e kë nuk pyeta,  
Ndonse me halle, është' e dhëmshur jeta.  
Pyeta një plakë, që kam në mëhallë,  
Tha: «Je ogradisur, paske shkelur djallë.»  
Dhe më nomatishi dhe më shoi thëngjij,  
Më bëri me krypë: «Bir, merak mos kij,  
Ti, në mos ke shkelur, ke këputur mish.»  
S'më bëri gjë plaka... Gjeta një dervish:  
— Ejvallah! — i thashë — jam në ditë halli!  
Dhe ky, anagjore: — Të ka zënë djalli...  
Fshtimu me këtë letër dhe thuaj u binde.,  
Se ty, mor evlat, të kan' zënë xhinde.»  
Pyeta një hoxhë: — Hoxhë efendi,  
Të lutem, më thuaj ndonj' ilaç mos di,

---

1) U botue në revistën «Bota e Re», Korçë. Viti I.  
Nr. 13. Datë 15 Tetor 1936. me pseudonimin Kapa. E  
japim të plotë.

Se jam i pamundur e nuk kam fuqi... —  
 Shpejt e nxjerr divitnë, më jep hajmalí,  
 Po dhe hajmalia shkoi ashtu si shkoi;  
 Dhe smundjen, që pata, ma la, s'ma shëroi.  
 Fundja, më së fundi, takonj një uratë:  
 — As aman, o prift, se bëra mëkatë,  
 Nuk kam lënë hoxhë, s'kam lënë dervish,  
 Veç tek ti kam shpresë, veç ti do ta dish  
 Të ma shporrësh smundjen, që më shtin lëngatë:  
 Jam njeri me halle, bëfsh hair, uratë!»  
 Urata i shenjtë me shtëllungën lesh:  
 — Dëgjo, bir — më thotë -- tjetër her' mos vesh  
 Nëpër hoxhallarë, nëpër dervishlerë,  
 Se ata të rjepin, un' kam çmim të prerë;  
 Vetëm një dollar të mbarohet halli.  
 Qofshin dhe kukunjtë,<sup>1)</sup> qoftë vetë djalli.»  
 Iku dhe urata, punë s'më mbaroi  
 Sëmundjen që kisha, as ky s'ma shëroi;  
 Në gjithë vakëfet dërgova qirinj,  
 U lava në jaze, fjeta në mullinj...  
 Të gjitha i bëra, s'lashë gjë eksiq,<sup>2)</sup>  
 Sëmundja s'më hiqet, më mundon, më vdiq...

.....  
 Plaka nomatisi, dervisni më shkroi.  
 Hoxha më dha nuskë, prifti më këndoi,  
 Cilido, pas qejfit, më rovi, më çveshi.  
 Mir' ma bënë, e desha, kshtu pëson syleshi.  
 Tashi s'më ka mbetur tjetër për të bërë,  
 E kam nisur punën me radhë, me sërë,  
 T'i vete doktorit, të nxjerr një merak,  
 Se humba fuqinë dhe mbeta pa gjak.

1) Kukudhët, lugetërit.

2) S'lashë gja pa bamë.

## SAZEXHIU FATKEQ 1)

Rrugës po kalonja, pran' një falëtore,  
Një djalë po hiqte një plakë për dore;  
Më tej, një sakat me këmbën e prerë,  
Një plak mjaft i krrusur qëndronte në derë...  
Të gjith' të rreckosur, fytyrë vrerosur.  
Po hallet e tyre s'u kishin dhe sosur,  
Se lypnin lëmoshë nga njerës bujarë,  
Me shpirt të këputur, me zë duke qarë...  
Më vinte të qanja dhe kisha inat;  
Kur një vjen më thotë: «E kanë zanat!»  
Çudi ky zanat! E ç'far' mjeshtërie?  
Askujt s'i përshtatet, askujt s'i ka hie.  
Pse kshtu katandisen e pse përqafojnë  
Zana'in e keq ku, vallë, e mësojnë?...  
....Vërej plakn' e krrusur; e dini kush qe?  
Një plak sazexhi, që loste me fé,

---

1) U botue te «Bota e Re», Korçë, Viti I, Nr. 20, datë 30 Janar 1937, me pseudonimin: Kapa. E japim të plotë,

Dikur në një kohë, dikur një zëmë.  
«Qanite një herë» 1), iu lutshin «aman»,  
Një vals, një tango, një këngë kaba!  
Kënaqeshin, dëfrenin dhe thoshin që «s'ka  
Si ti, haj, qanite, ashtu, mos vdeksh kurrë!»  
Dhe nxeheshin e deheshin e bëheshin si furrë.  
I bënte qejflinj dhe burrat dhe gratë,  
Në ballin e dirsur i ngjitnin paratë,  
Por ç'e do, se dora filloi që t'i dridhet  
Dhe zëri t'i ngjirret dhe trupi t'i mblidhet.  
E sot? Ah, i ziu!... Këndon tjetër këngë,  
Me rrobat e tia, rreckosur, pa mëngë.  
Askush s'i kthen kryet, askush s'e pyet,  
Se është si pika, është në qamet!...  
Dëfren njerëzia, dëfren kur ka qeif,  
Të vdesë, të endet, të lypë, të meket:  
Të mban, kur i duhesh, të zbon, kur i teket.

---

1) Qaje një herë.